




Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

11/2019

Drejtësia administrative në Kosovë, ligji VS praktika



Prishtinë, shtator 2019

Autor: Kaltrina Ajvazi

Ekipi i Redaktorëve: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Yll Zekaj dhe Gzim Shala

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Shtator 2019

Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	3
1. Përmbledhje ekzekutive	4
2. Metodologjia	6
3. Korniza Ligjore	7
3.1. Mjetet Efektive Juridike: Konventat Ndërkombëtare dhe zbatimi në praktikë.....	9
4. Ngarkesa e Departamentit për Çështje Administrative në GTH në Prishtinë	11
4.1. Ngarkesa ndër vite e Departamentit për Çështje Administrative të GJTH në Prishtinë	11
4.2. Ngarkesa më lëndë në Departamentin për Çështje Administrative të GJTH në Prishtinë gjatë vitit 2018 dhe gjashtëmujorit të parë të vitit 2019	12
5. Ngarkesa dhe performanca individuale e gjykatësve me raste në Departamentin për Çështje Administrative.....	14
6. Ngarkesa e Departamentit për Çështje Administrative në Gjykatën e Apelit.....	16
6.1. Ngarkesa dhe performanca individuale e gjykatësve me raste në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit	17
7. Ngarkesa me lëndë Administrative në Gjykatën Supreme.....	20
8. Analiza e rasteve dhe trajtimi i tyre në DÇA NË GjTh në Prishtinë	21
8.1. Gjetjet e IKD-së mbi Departamentin për Çështje Administrative	21
8.1.1. Kohëzgjatja e zgjidhjes së lëndëve në Departamentin për Çështje Administrative	22
8.1.2. “Ping Pongu” me rastet në Drejtësinë Administrative	27
8.1.3. 200 lëndët “stand-by” nga Gjykata e Apelit për më shumë se 5 vite.....	28
9. Annex 1: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike Administrative të përfunduara me aktgjykim të formës së prerë.....	31
10. Annex 2: Analizë e detajuar e rasteve karakteristike Administrative të cilat gjenden në procedurë ankimore	44
11. Rekomandime.....	52

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka materializuar standardet më të larta në lidhje me garancinë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta njihet si akti më i lartë juridik i vendit, në harmoni me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore. Rregullimi i drejtësisë administrative sipas legjislacionit të shtetit të Kosovës, bëhet së pari në bazë parimeve Kushtetuese, e më pas sipas ligjeve përkatëse për këtë fushë.

Me qëllim të garantimit të gjyqësisë administrative, Ligji për Gjykatat i Republikës së Kosovës i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, ka themeluar edhe Departamentin për Çështje Administrative (DÇA), i cili departament funksion në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë si shkallë e parë për këto raste, me kompetencë për tërë territorin e Kosovës, por edhe në Gjykatën e Apelit si shkallë e dytë, e cila shqyrton ankesat në këto raste.

Nga gjetjet e Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD) në këtë raport vërehet se në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, (GjTh) përqindja e numrit të lëndëve të pazgjidhura është rritur vit pas viti, nga 68.35% sa ka qenë në vitin 2016, në 80.21% më 30 qershor 2019. Kjo ka ndodhur edhe përkundër faktit se nga viti 2016 deri në vitin 2019, nuk ka rritje drastike të numrit të lëndëve në punë në raport me vitet paraprake. Në anën tjetër, përjashtimisht ka pasur disa lëvizjeve në këtë departament gjatë vitit 2018¹, numri i gjyqtarëve në këtë departament nuk është zvogëluar asnjëherë, por e kundërta, është rritur numri i gjyqtarëve. Edhe sa i përket zgjidhjes së lëndëve në numër, ky numër ka rënë vazhdimisht nga viti 2016 e deri në kohën raportuese.

Ndonëse gjatë vitit 2018 dhe gjashtë (6) mujërit të parë të vitit 2019 gjyqtarët e Departamentit për Çështje Administrative (DÇA) në GjTh të Prishtinës kanë arritur normën vjetore, kjo performancë dhe ky numër i gjyqtarëve nuk garanton gjykim në kohë të arsyeshme sa i përket lëndëve që i takojnë drejtësisë administrative.

Përmes një analize të thellë të aktgjykimeve të DÇA-së, IKD-ja ka gjetur se të njëjtat nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm, në atë mënyrë që palët dhe publiku realisht të kuptojnë dhe të binden se pse në një rast të caktuar Gjykata ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit. Aktgjykimet e rasteve të monitoruara tregojnë në mënyrë të shkurtër kthimin e një rasti në rivendosje në rastet kur aprovohet padia duke mos u lëshuar në një arsyetim konkret dhe në rekomandime konkrete për organin administrativ që do të shqyrtoj rekomandimin e gjykatës kur rasti kthehet në rivendosje tek të njëjtit.

Sipas vlerësimit të IKD-së përmbledhja e atyre çka janë thënë në seancë nuk përbën arsyetim të një vendimi kur mungon arsyetimi i bazës mbi të cilën është refuzuar një padi nga kjo gjykatë. Mundësia e lejuar me ligj që gjykatësit e këtij departamenti rastet ti kthejnë në rivendosje sipas IKD-së po iu mundëson atyre që të vendosin në mënyrë formale për të njëjtat pa dhënë arsyetim të plotë për refuzimin apo aprovimin e padive. Gjykatësit e këtij departamenti në shumë pak raste vendosin në mënyrë meritore për një çështje pa e dërguar fillimisht rastin në rivendosje, duke

¹ Shënim: Departamenti Administrativ në fillim të vitit 2018 kishte vetëm 5 gjykatës pasi që 2 prej tyre kishin shkuar për një trajnim një vjeçar në Amerikë. Gjatë vitit 2018 dy gjykatësit u kthyen, ndërsa në nëntor të vitit 2018 u shtuan edhe dy gjykatës të rinj duke bërë që numri i gjykatësve në këtë departament të jetë nëntë.

bërë që shkalla e përgjegjësisë të jetë më e ulët. Sipas të dhënave që IKD ka nxjerrë pas analizimit të aktgjykimeve aprovuese, është gjetur se 90% e këtyre aktgjykimeve janë aktgjykime sipas të cilat rasti kthehet në rivendosje në organin administrativ.

Në DÇA të GjTh në Prishtinë sipas të dhënave të kësaj gjykate kohëzgjatja e trajtimit të një rasti prej momentit kur padia paraqitet në gjykatë e deri në ditë kur merret vendimi nga e njëjta është 947 ditë për lëndët e Departamentit Administrativ ndërsa 1189 ditë në Divizionin Fiskal (DF). Nga kjo mund të kuptojmë që një qytetarë për realizimin e të drejtës së tij përmes gjykatës, duhet të pres minimumi dy vite e gjysmë, e në rastet e gjykuara në DF mbi tri vite.

Një kohëzgjatje kaq të madhe të procedurës nuk e kemi në DÇA të Gjykatës së Apelit. Për dallim nga DÇA i GjTh në Prishtinë, në DÇA të Gjykatës së Apelit kohëzgjatja e procedurës është 8 deri në 10 muaj.

Nga monitorimi sistematik në këtë departament, IKD ka gjetur se praktika e krijuar nga ana e gjykatës lidhur me vendosjen apo dhënien e verdiktit në çështje administrative është një formë e cila ndikon negativisht në administrimin e drejtësisë, e cila po ndikon në zvarritjen e rasteve. Në këtë mënyrë krijohen procedura të panumërta që nuk po arrijnë të përfundohen me vite.

Shumë shkallëshmëria, mos zgjidhja e lëndëve në kohë të arsyeshme, “shëtitja” e palëve nga një organ në tjetrin për marrje të një përgjigje ka ndikuar në krijimin e një lloji “Ping Pongu” me lëndët administrative. Kjo më së shumti është e shprehur në kthimin e lëndëve nga DÇA i GjTh në Prishtinë në organin administrativ të shkallës së dytë.

Në LKA përcaktohet që “nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve”. Kjo dispozitë i përshtatet edhe vetë natyrës së procedurës administrative, në mënyrë që të mos pengohet administrimi i mirë i drejtësisë, ndonëse jo në secilin rast, kjo mund të jetë në dobi të palës e cila mungon.

Dukuria e mos paraqitjes në seancë është dukuri jashtëzakonisht e shprehur në rastet kur të paditura janë organet shtetërore, e që përfaqësohen nga Avokatura Shtetërore (ASh) që funksionon kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD). Mos pjesëmarrja e organeve shtetërore, të cilat shpesh edhe nuk sjellin as provat e nevojshme për rastet përkatëse tregon një neglizhencë të institucioneve për tu marrë me qytetarë që i atakojnë vendimet e tyre në procedura administrative. Thënë më ndryshe, kjo dukuri tregon mungesën e ASh-së për mbrojtjen e interesit publik. Përpos seancave, IKD ka analizuar edhe përgjigjet në padi që i bëjnë këto institucione në raste në gjykatë e të cilat janë të njëjta vetëm ndryshon emri dhe mbiemri i paditësit. Në këtë mënyrë, ASh ka krijuar një praktikë “shabllone” për trajtimin e këtyre rasteve, e që një praktikë e tillë më së paku nënkupton mbrojtje efektive dhe efikase të interesit publik.

2. METODOLOGJIA

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e rasteve në Departamentin për Çështje Administrative, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare përfshi legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të KGJK-së, si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga institucionet gjyqësore përmes kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përpos këtyre dokumenteve, përpilimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së gjyqtarëve në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve në DÇA në GjThnë Prishtinë. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD-ja tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit gjyqësor.

Ky raport përfshin monitorimin e rasteve të DÇA-së të GjTh në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit, për periudhën kohore 1 janar 2018 – 30 qershor 2019. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë disa prej rasteve më karakteristike të DÇA-së .

Sa i përket DÇA-së së GjTh në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, IKD në këtë raport ka analizuar ngarkesën me lëndë të këtij departamenti, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, performancën individuale të gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport ka dhënë vlerësimet dhe rekomandimet konkrete se si duhet të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti në trajtimin e këtyre rasteve.

Sa i përket rasteve të natyrës administrative, IKD-ja gjatë vitit 2018 dhe gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2019 ka mbledhur afërisht 100 aktgjykime nga 133 seancave të monitoruara, të cilat kanë përfunduar në shkallë të parë.

Në këtë raport, IKD ka analizuar gjetjet kryesore nga monitorimi sistematik i drejtësisë administrative, derisa në annexin 1 të këtij raporti do të trajtohen edhe raste të përzgjedhura të proceseve gjyqësore administrative.

3. KORNIZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka materializuar standardet më të larta në lidhje me garancinë dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kushtetuta njihet si akti më i lartë juridik i vendit, në harmoni me të cilin duhet të jenë të gjitha aktet e tjera ligjore e nënligjore. Rregullimi i drejtësisë administrative sipas legjislacionit të shtetit të Kosovës, bëhet së pari në bazë parimeve Kushtetuese, e më pas sipas ligjeve përkatësve për këtë fushë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtën e mjeteve juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që shkelin të drejtat ose interesat e qytetarëve të saj. Kushtetuta gjithashtu ka vendosur si kriter se mjetet juridike, përveç që janë në dispozicion, gjithashtu duhet të jenë efektive. Kjo Kushtetutë parasheh në mënyrë decitive të drejtën në mjete efektive: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*².

Sa i përket Drejtësisë Administrative, Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (LKA) është ligji bazë mbi të cilin zhvillohet një procedurë gjyqësore administrative. Ky ligj ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2010.

Ky ligj përcakton në mënyrë të qartë dhe konkrete çdo hap që një qytetar, i cili mendon se ka parregullsi në vendime të organeve shtetërore duhet të ndjek në mënyrë që të realizoj të drejtën e tij. Thënë më ndryshe, ky ligj jetëson drejtësinë administrative në Republikës e Kosovës.

Procedura pranë organit administrativ fillon gjithmonë me një kërkesë të palës apo qytetarit me anë të së cilës i njëjti kërkon një shërbim. Kjo procedurë në parim rregullohet me Ligjin nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA).

Pavarësisht se në cilin institucion parashtrohet kërkesa, sipas LPPA-së, kjo kërkesë duhet të shqyrtohet brenda një afati të arsyeshëm kohor, ku sipas nenit 10 të këtij ligji thuhet se *“Organi publik zhvillon procedurën administrative sa me të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative”*.

Ndaj çdo vendimi që merret në procedurë administrative ligji parasheh të drejtën për ankesë si mjet i rregullt juridik. E gjithë kjo procedurë, sipas LKA-së, duhet t'i paraprijë konfliktit administrativ.

Në bazë të ligjit kur një qytetar nuk është i kënaqur me një vendim administrativ, i njëjti mund të kërkoj nga një shkallë më e lartë rishikimin e atij vendimi përmes ankesës ose nëse ndaj vendimit të shkallës së parë nuk lejohet ankesa, përmes padisë në gjykatë.

Vendimi i parë mund të atakohet në po të njëjtin institucion ku është paraqitur fillimisht kërkesat për çfarë do shërbimi, kjo ankesë duhet të shqyrtohet nga një instancë më e lartë.

² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 32.

Shkalla e dytë brenda këtij organi administrativ është ajo që shqyrton ankesën dhe të njëjtën ka dy forma për ta kthyer tek pala, mund të refuzoj ankesën si të pabazuar dhe vendimin e shkallës së parë ta lë në fuqi, ose që vendimin e shkallës së parë ta anulojë dhe të vendos se pala ka të drejtë në kërkesën e tij. Në rastet në të cilat as shkalla e dytë e organit administrativ, nuk vendos në favor të palës, për këtë për personin që ka pakënaqësi parashihet e drejta për inicim të konfliktit administrativ që zhvillohet në GjTh në Prishtinë, DÇA, që pranon lëndë nga të gjitha vendet e Kosovës.

Në bazë të kësaj dy vendime marren nga organi administrativ, ndërsa në gjykatë mund të ketë edhe tri vendime për të njëjtin rast duke e dërguar numrin e vendimeve për një rast në 5 vendime (2 administrative dhe 3 gjyqësore) derisa arrihet një vendim përfundimtar. Në rast se gjykata vendos që të kthejë një çështje në rivendosje në organin administrativ atëherë numërohen tri vendime administrative e më pas edhe tri vendimi gjyqësore.

Përpos kësaj, edhe pas vendosjes së një lënde gjyqësore administrative nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pala mund t'i drejtohet edhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, që e dërgon në 7 numrin e vendimeve për një rast administrativ.

Kur një lëndë pranohet në Gjykatë me anë të konfliktit administrativ me ligj parashihen tri lloje të vendimeve që e njëjta mund të marr. GjTh në Prishtinë respektivisht DÇA-ja e mund të vendos për kërkesat e palëve në mënyrë meritore, të bëj kthimin e rastit në rivendosje në organet administrative dhe që kërkesën e palës ta refuzoj.

Në bazë të LKA-së, gjykatësve iu mundësohet e drejta që një rast nëse vërtetojnë se janë bërë shkelje gjatë vendosjes në organe administrative ta rikthejnë në atë organ për mënjanim të gabimeve ligjore të bëra herën e parë. Organi i administratës obligohet që të marrë sërish vendim lidhur me kërkesën e palës gjithnjë sipas udhëzimeve të GjTh në Prishtinë dhënë në aktgjykim.

Tri vendimet e organeve administrative, pala e pakënaqur mundet që sërish me anë të konfliktit të dytë administrativ të filloj procedurën në GjTh në Prishtinë, DÇA.

Edhe pse LKA-ja nuk e parasheh një gjë të tillë decidivisht, gjykata kur për rastin e njëjtë paraqitet dy herë padia, në herën e dytë vendos meritorisht pa e kthyer rastin në organin administrativ, të paktën kjo është praktikë e evidentuar nga monitorimi sistematik që IKD i bënë këtij departamenti. Më pas i takon Gjykatës së Apelit të merret me ankesat e palëve të pakënaqura me vendimin e GjTh në Prishtinë.

Deri në vitin 2013, kompetente për zgjidhjen e rasteve nga konflikti administrativ ka qenë Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, dhe jo edhe Gjykatat e tjera. Në këtë mënyrë, vendosja e këtyre rasteve drejt për së drejti nga Gjykata e shkallës më të lartë, ka kufizuar të drejtat e palëve në ushtrimin e mjeteve juridike.

Më 1 janar 2013 ka hyrë në fuqi ligji Nr.03/L-199 për Gjykatat, sipas të cilit për gjykimin e rasteve në konflikt administrativ themelohet Departamenti për Çështje Administrative pranë

Gjykatës Themelore në Prishtinë. Ky ligj është shfuqizuar me Ligjin Nr.06/L-054 për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019.

Neni 13.4 i Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat përcakton decidivisht se “Çështjet administrative janë kompetencë ekskluzive e Gjykatës Themelore të Prishtinës”. Ndërsa, sa i përket organizimit të brendshëm të Gjykatave, ky ligj përcakton se “Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës”³.

Tutje, ky ligj përcakton:

Neni 17

Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës

1. Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës, gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.
2. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.
3. Në kuadër të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, funksionon Divizioni Fiskal, në lidhje me paditë e ushtruara kundër akteve përfundimtare administrative, në çështjet që kanë të bëjnë me çështjet doganore dhe tatimore, tatimi mbi pronën e paluajtshme dhe çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Republikën e Kosovës

Po ashtu, ligji në fjalë përcakton edhe themelimin e këtij departamenti për kuadër të Gjykatës së Apelit⁴, derisa për mjetet e jashtëzakonshme juridike, kompetencë për vendosje ka Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës⁵.

3.1. MJETET EFEKTIVE JURIDIKE: KONVENTAT NDËRKOMBËTARE DHE ZBATIMI NË PRAKTIKË

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton se marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare dhe normat ligjore detyruese të së drejtës ndërkombëtare kanë përparësi mbi ligjet e Republikës së Kosovës⁶.

Me qëllim të afirmimit sa më të lartë të mbrojtës së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, Kushtetuta e Republikës ka inkorporuar në sistemin kushtetues dhe juridik të Republikës së Kosovës tetë (8) instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të cilat kanë përparësi absolute ndaj ligjeve të tjera⁷. Prej këtyre instrumenteve, ndër

³ Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 13.1.3.

⁴ Po aty, neni 24.1.5.

⁵ Po aty, neni 26.

⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 19.2.

⁷ Po aty. Neni 22. “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast

më të rëndësishmet është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

Për më tepër, Neni 53 i Kushtetutës përcakton se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Kjo dispozitë i detyron të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe gjykatat, që të zbatojnë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kur vendosin për çështje të cilat kanë impakt në të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, pra edhe çështjet administrative.

Në këtë drejtim, neni 13 i kësaj konvente garanton të drejtën për një mjet efektiv juridik:

Neni 13:

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Sa i përket “*zgjidhjes efektive*”, me këtë nocion kuptohet mekanizmi i duhur dhe funksional gjyqësor dhe administrativ për të trajtuar dhe vendosur mbi pretendimet për shkelje sipas ligjit vendas.

Sa i përket “*zgjidhjes efektive*”, GjEDNj në jurisprudencën e saj ka ndërtuar standarde dhe përkufizime të këtij nocioni.

Në rastet *McFarlane v. Ireland* dhe *Riccardi Pizzati v. Italy*, GjEDNj ka nënvizuar se një mjet juridik është efektiv vetëm nëse është i arritshëm dhe merit⁸, derisa në rastet *El-Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* dhe *Kudła kundër Polonisë*, kjo Gjykatë ka potencuar se efektshmëria e një mjeti juridik duhet të jetë e zbatueshme si në praktikë, ashtu edhe në rregullimin ligjor⁹.

Në këtë mënyrë, institucionet e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës duhet t’i kushtojnë shumë rëndësi kësaj jurisprudence, e cila edhe obligon të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, në rastin konkret sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, sistemi gjyqësor duhet ta ketë parasysh pozicionin dhe rëndësinë që ka mjeti juridik efektiv në Republikën e Kosovës, pasi mungesa e një mjeti të tillë, është drejt për së drejti mos zbatim i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si akti më i lartë juridik në hierarkinë ligjore të Republikës së Kosovës.

konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”.

⁸ *McFarlane v. Ireland*. European Court for Human Rights. 10 September 2010. paragraph 114; *Riccardi Pizzati v. Italy*. European Court for Human Rights. 29 March 2006 paragraph 38.

⁹ *El-Masri v. “the former Yugoslav Republic of Macedonia”*. European Court of Human Rights. 13 December 2012. paragraph 255 dhe *Kudła v. Poland*. European Court of Human Rights. 26 October 2000. paragraph 152.

4. NGARKESA E DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE NË GJTH NË PRISHTINË

Më qëllim të krijimit të një pasqyre sa më reale, e cila do të tregonte edhe trendet e performancës së DÇA-së ndër vite, IKD ka analizuar trendin e lëndëve në këtë departament që nga viti 2016 e deri më 30 qershor 2019.

Për të pasur një konstatim sa më të saktë, IKD ka bërë një analizë të thukët të numrit të lëndëve që trashëgohen vit pas viti, numrin e lëndëve në punë, lëndëve të zgjidhura etj, mbi të cilat gjetje, IKD ka dhënë edhe vlerësime.

4.1. NGARKESA NDËR VITE E DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE TË GJTH NË PRISHTINË

Me qëllim të pasqyrimin sa më të saktë të punës ndër vite të DÇA-së të GjTh në Prishtinë, IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë që ky departament ka pasur që nga viti 2016 e deri më 30 qershor 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, DÇA i GjTh në Prishtinë gjatë vitit 2016 ka pasur në punë gjithsej 7,596 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2,404 apo 31.64% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 5,192 lëndë apo 68.35% e tyre.

Gjatë vitit 2017, ky departament gjithsej në punë 7,572 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 2,268 apo 39.95 % të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 5,304 apo 70.04% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, DÇA i GjTh në Prishtinë ka pasur në punë 8,312 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 2,219 ose 26.69% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 6,093 ose 73.30% e tyre.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, departamenti në fjalë ka pasur në punë 7,631 lëndë, prej të cilave gjatë kësaj periudhe kanë zgjidhur 1,510 apo 19.78%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 6,121 apo 80.21% e lëndëve.

Nga këto gjetje shihet se në DÇA të GjTh në Prishtinë, përqindja e numrit të lëndëve të pazgjidhura është rritur vit pas viti, nga 68.35% sa ka qenë në vitin 2016, në 80.21% më 30 qershor 2019. Kjo ka ndodhur edhe përkundër faktit se nga viti 2016 deri në vitin 2019, nuk ka rritje drastike të numrit të lëndëve në punë. Në anën tjetër, përjashtimisht ka pasur disa lëvizjeve në këtë departament gjatë vitit 2018,¹⁰ por numri i gjyqtarëve në këtë departament nuk ka rënë asnjëherë, por ka ndodhur e kundërta, është rritur numri i gjyqtarëve. Edhe sa i përket zgjidhjes së lëndëve në numër, ky numër ka rënë vazhdimisht nga viti 2016 e deri tash.


Sipas IKD-së, këto gjetje tregojnë mos interesimin e sistemit gjyqësor për uljen e numrit të lëndëve në DÇA të GjTh në Prishtinë. Nga viti 2016 e deri tash, gjetjet e IKD-së të prezantuara më poshtë në këtë raport thonë se sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës nuk garanton mjete juridike efektive, për shkak të vonesave të mëdha për trajtimin e lëndëve. Përballë kësaj situatë,

¹⁰ Shënim: Departamenti Administrativ në fillim të vitit 2018 kishte vetëm 5 gjykatës pasi që 2 prej tyre kishin shkuar për një trajnim një vjeçar në Amerikë. Gjatë vitit 2018 dy gjykatësit u kthyen, ndërsa në nëntor të vitit 2018 u shtuan edhe dy gjykatës të rinj duke bërë që numri i gjykatësve në këtë departament të jetë nëntë.

ky departament nga viti 2016 e deri tash vetëm se e ka ruajtur “status quon”, por nuk ka shënuar asnjë rezultat në kuptim të uljes së numrit të lëndëve të pazgjidhura, lëndë të cilat barten vit pas viti.


4.2. NGARKESA MË LËNDË NË DEPARTAMENTIN PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE TË GJTH NË PRISHTINË GJATË VITIT 2018 DHE GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT 2019

Gjatë vitit 2018, DÇA i GjTh në Prishtinë ka pasur në punë 8,312 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 2,219 ose 26.69% të tyre, ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 6,093 ose 73.30% e tyre.



Grafika 1: Përqindja e lëndëve të përfunduara në Gjykatën Themelore gjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2018, ky departament ka trashëguar nga viti 2017 gjithsej 5,304 lëndë, derisa ka pranuar edhe 3,008 lëndë të reja. Prej këtyre lëndëve, ky departament ka zgjidhur 2,219 lëndë, derisa ka bartur për vitin 2019 gjithsej 6,093 lëndë.



Grafika 2: Paraqitja e numrit të lëndëve të trashëguara nga viti 2017 dhe lëndët e pazgjidhura të mbetura për vitin 2019.

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019, departamenti në fjalë ka në punë 7,631 lëndë, prej të cilave gjatë kësaj periudhe kanë zgjidhur 1,510 apo 19.78%, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 6,121 apo 80.21% e lëndëve.

Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, DÇA në GjTh në Prishtinë ka trashëguar nga viti 2018 gjithsej 6,093 lëndë, derisa ka pranuar edhe 1,538 lëndë të reja. Prej këtyre lëndëve, ky departament ka zgjidhur 1,510 lëndë, derisa ka lënë të pazgjidhura edhe 6,121 lëndë

Ndonëse gjatë vitit 2018 dhe gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019 gjyqtarët e DÇA-së GjTh të Prishtinës kanë arritur normën vjetore, kjo performancë dhe ky numër i gjyqtarëve nuk garanton suksesin sa i përket numrit të lëndëve të pazgjidhura të cilat barten vit pas viti.

Edhe gjatë vitit 2018 por edhe gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019 ky departament ka kryer lëndë më pak se sa që ka pranuar, që rrjedhimisht nënkupton rritjen e numrit të pazgjidhura të lëndëve të cilat barten vit pas viti.

Nëse i shohim të dhënat për vitin 2018, atëherë shohim se gjatë këtij viti ky departament ka zgjidhur gjithsej 2,219 lëndë, derisa janë bartur për vitin 2019 edhe 6,093 lëndë të tjera. Nga këto të dhëna, shihet se për t'i përfunduar vetëm lëndët e pazgjidhura, pra pa pranuar as edhe një lëndë tjetër, këtij departamenti i nevojiten edhe 3 vite kohë, përkatësisht deri në fillimin e vitit 2022.

Për këtë arsye, IKD vlerëson se është e domosdoshme që KGJK t'i qaset kësaj gjendje, në mënyrë që të ulë numrin e lëndëve të pazgjidhura që barten vit pas viti, në mënyrë që ky departament të mund të zbatojë në praktikë të drejtën për mjete efektive juridike.

5. NGARKESA DHE PERFORMANCA INDIVIDUALE E GJYKATËSVE ME RASTE NË DEPARTAMENTIN PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Gjatë vitit 2018, DÇA ka qenë i ngarkuar me gjithsej 8,312 lëndë, derisa në këtë departament kanë qenë të angazhuar gjithsej 9 gjyqtarë.

Në mesatare i bie se gjatë vitit 2018, secili gjyqtar ka pasur në punë rreth 923 lëndë.

Ndërsa, gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, DÇA në GjTh të Prishtinës ka qenë i ngarkuar me gjithsej 7,631 lëndë, derisa edhe gjatë kësaj periudhe, në këtë departament kanë qenë të angazhuar 9 gjyqtarë.

Në mesatare, kjo i bie se gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, secili gjyqtar në këtë departament ka qenë i ngarkuar me gjithsej rreth 847 lëndë.

Sa i përket numrit të lëndëve të zgjidhura, gjatë vitit 2018, ky departament ka zgjidhur gjithsej 2,219 lëndë, që në mesatare i bie se secili gjyqtar ka zgjidhur nga rreth 246 lëndë.

Ndërsa, gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019, ky departament ka zgjidhur gjithsej 1,510 lëndë, që në mesatare i bie se secili gjyqtar ka zgjidhur nga rreth 167 lëndë.

KGJK në fillim të vitit 2019 ka bërë një progres në fushën e transparencës me publikun, mediat dhe shoqërinë civile, në atë mënyrë që ka publikuar Raportin Vjetor Statistikor për Punën e Gjyqtarëve për vitin 2018. Në këtë raport, pasqyrohet numri i lëndëve që secili gjyqtar ka kryer gjatë vitit 2018.

Këtë veprim KGJK nuk e ka bërë për 6 mujorin e parë të vitit 2019, derisa këtë e ka bërë GjTh e Prishtinës, duke publikuar Raportin Statistikor për Punën e Gjyqtarëve në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019.

Ndër to, janë publikuar edhe statistikat për lëndët e zgjidhura në DÇA ku pasqyrohet edhe efikasiteti i çdo gjykatësi në këtë departament.

Gjatë vitit 2018 sipas këtyre statistikave pesë gjykatës të këtij departamenti kanë zgjidhur përafërsisht secili nga 350 lëndë në vit, ndërsa mesatarja e lëndëve të zgjidhura për një muaj është nga 25 lëndë deri në 40.

Emri i gjykatësit	Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë vitit 2018
Hajriz Hoti	360
Anita Nikqi-Morina	364
Lirije Maksutaj	351
Luljeta Maxhuni	387
Arjeta Sadiku	173
Krenar Berisha	344
Rexhep Gashi	6
Vjollca Limani	9
Ramush Bardiqi	153

Tabela 1: Numri i lëndëve të zgjidhura nga gjyqtarët gjatë vitit 2018.

Gjykatësit Ramush Bardiqi dhe Arjeta Sadiku, të cilët ishin në një trajnim një vjeçar në Shtetet e Bashkuara në Amerikë, sipas statistikave nga muaji qershor 2018 kur ishin kthyer në punë deri në fund të vitit kanë përfunduar secili nga 150 lëndë.

Ndërsa gjykatësit Rexhep Gashi dhe Vjollca Limani, të cilët në dhjetor të vitit 2018 kishin ardhur si gjykatës të ri kanë zgjidhur vetëm në muajin dhjetor së bashku 15 lëndë.

Sipas Rregullores për Caktimin e Normave të Punës së Gjyqtarëve të përcaktuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës(KGJK), gjykatësit në DÇA në GjTh në Prishtinë, normë mujore kanë 27 lëndë të përfunduara, ndërsa normë vjetore kanë 339 lëndë .

Nga statistikat e lartcekura rezulton se gjykatësit në këtë departament gjatë vitit 2018 kanë përmbushur normën e caktuar si atë mujore po ashtu edhe atë vjetore.

Ndërsa për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019 po ashtu të njëjtit kanë përmbushur normën e tyre mujore, ku në total për këtë periudhë nëntë gjykatësit e këtij departamenti kanë zgjidhur 1510 lëndë.

Emri i gjykatësit	Numri i lëndëve të zgjidhura për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019
Hajri Hoti	183
Anita Nikqi-Morina	170
Lirije Maksutaj	177
Luljeta Maxhuni	166
Arjeta Sadiku	164
Krenar Berisha	184
Rexhep Gashi	154
Vjollca Limani	151
Ramush Bardiqi	161

Tabela 2: Numri i lëndëve të zgjidhura gjatë gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019.

Po ashtu, në këtë statistikë vërehet se nuk ka një disbalancë të theksuar mes numrit të lëndëve që kryen secili gjyqtarë.

6. NGARKESA E DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE NË GJYKATËN E APELIT

Gjykata e Apelit si shkallë e dytë e cila shqyrton ankesat e qytetarëve ndaj vendimeve të shkallës së parë, në DÇA ka tre gjykatës.

Kjo gjykatë siç edhe LKA-ja e ka paraparë shqyrton ankesat lidhur me vendimet e marra nga Gjykata Themelore në Prishtinë për rastet që janë në konflikt administrativ me inicim qoftë të qytetarëve apo edhe institucioneve shtetërore.

Gjetjet e IKD-së tregojnë se Gjykata e Apelit, respektivisht DÇA , krahasuar me shkallën e parë ka numër më të vogël të lëndëve dhe zgjidhja e tyre bëhet më shpejt sesa zgjidhja e rasteve në Themelore.

Me qëllim të pasqyrimin më të saktë të trendit të numrit të lëndëve ndër vite në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës së Apelit, IKD ka analizuar statistikën zyrtare të KGJK-së për këtë departament sa i përket vitit 2016, 2017, 2018 dhe gjashtë (6) mujorit të parë të vitit 2019.

Në bazë të raporteve statistikore të gjykatave që KGJK publikon çdo vit kalendarik, DÇA i Gjykatës së Apelit gjatë vitit 2016 ka pasur në punë gjithsej 760 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 426 apo mbi 56% të lëndëve, ndërsa i kanë mbetur të pazgjidhura 334 lëndë apo afër 44% të lëndëve.

Gjatë vitit 2017, ky departament gjithsej në punë 890 lëndë, prej të cilave i kanë zgjidhur 472 apo mbi 53% të lëndëve, ndërsa kanë mbetur të pazgjidhura 418 apo afër 47% të lëndëve.

Gjatë vitit 2018, DÇA i Gjykatës së Apelit ka pasur në punë 1,083 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 748 ose mbi 69% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 335 ose afër 31%.

Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, DÇA i Gjykatës së Apelit ka pasur në punë gjithsej 766 lëndë, prej të cilave kanë zgjidhur 427 ose 55.74% ndërsa numri i lëndëve që kanë ngelur të pazgjidhura është 339 ose 44.25%.

Nga këto statistika shihet se DÇA i Gjykatës së Apelit sa i përket numrit të lëndëve të pazgjidhura qëndron më mirë se sa DÇA në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Nga statistikat e mësipërme shihet se DÇA i Gjykatës së Apelit ka ulur ndër vite përqindjen e numrit të lëndëve të pazgjidhura, derisa kemi një ngritje të lehtë në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019.


6.1. NGARKESA DHE PERFORMANCA INDIVIDUALE E GJYKATËSVE ME RASTE NË DEPARTAMENTIN PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE TË GJYKATËS SË APELIT

Gjatë vitit 2019, DÇA në Gjykatën e Apelit ka pasur në punë gjithsej 1,083 lëndë, derisa në këtë departament kanë qenë të angazhuar 3 gjyqtarë.

Në mesatare i bie që secili gjyqtar ka qenë i ngarkuar me nga afër 361 lëndë.

Në gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2019, i njëjti departament ka pasur në punë gjithsej 766 lëndë.

Gjatë kësaj periudhe kohore, i bie se mesatarisht një gjyqtar ka qenë i ngarkuar me 255 lëndë.



Grafika 3: Paraqitja e numrit të lëndëve të trashëguara nga viti 2017 dhe lëndët e pazgjidhura të mbetura për vitin 2019.

Në bazë të statistikave të siguruar nga kjo gjykatë thuhet se deri në fund të vitit 2018 janë zgjidhur 748 lëndë për çështje administrative.

Vitin 2018, Gjykata e Apelit e filloi me 418 lëndë të trashëguara nga viti 2017, ndërsa gjatë vitit 2018 ka pranuar edhe 665 lëndë të reja.

Nga analiza e numrit të rasteve që janë zgjidhur në këtë vit, ato që janë trashëguar dhe kanë mbetur pa zgjidhur rezulton që efikasiteti i kësaj gjykatë në këto çështje ka qenë 112.5%.

Në fund të vitit 2018, në këtë departament të Gjykatës së Apelit është shtuar edhe një gjykatës, ndërsa me pranimin e gjykatësve të rinj në fillim të vitit 2019 është shtuar edhe një gjykatës në këtë departament.

Gjykata e Apelit, respektivisht DÇA i kësaj Gjykate sipas statistikave ka treguar rezultate të kënaqshme gjatë vitit 2018.

Ky departament në shkallën e dytë normën mujore sipas rregullores së përcaktuar nga KGJK-ja ka 22 lëndë që duhet të përfundohen brenda muajit, ndërsa norma vjetore që duhet të përmbushet është 263 lëndë.

Gjykatësja Delushe Halimi brenda vitit ka përfunduar 336, kurse gjykatësi Ramiz Kuqi 390 lëndë, ndërsa gjatë muajit janar, gjykatësi që tanimë nuk është pjesë e këtij departamenti, Ragip Namani kishte përfunduar 22 lëndë.


Sipas kësaj numri i përgjithshëm i lëndëve të përfunduara nga Gjykata e Apelit gjatë vitit 2018 ishte 748 lëndë.

Nga kjo rezulton se numri i lëndëve të zgjidhura është tre herë më i lartë se numri i lëndëve të parapara për tu zgjidhur sipas normës së përcaktuar në rregulloren e vendosur nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK).

Edhe sa i përket numrit të lëndëve të trashëguara, DÇA në Gjykatën e Apelit ka një gjendje shumë stabile. Përafërsisht, me këtë hap të kryerjes së lëndëve, i bie që nëse ky departament nuk pranon lëndë të reja, lëndët e pazgjidhura në fund të një periudhe raportuese do ti zgjidhë për afërsisht vetëm për 6 muaj.

Gjatë vitit 2018 në Gjykatën e Apelit janë zgjidhur 748 lëndë prej të cilave për 435 lëndë që kanë ardhur me ankesë në këtë gjykatë, është vërtetuar vendimi i shkallës së parë. 302 lëndë janë kthyer në rigjykim në Gjykatën Themelore të Prishtinës, në dy raste është hudhur ankesa, në një rast është ndryshuar vendimi i Gjykatës së shkallës së parë, ndërsa në tetë raste është vendosur në mënyra tjera.

Nga kjo rezulton se numri i lëndëve të kthyera në rigjykim në shkallën e parë është mjaftë i lartë.



Grafika nr 4: Mënyra e zgjidhjes së lëndëve në Gjykatën e Apelit gjatë vitit 2018.

Sa i përket gjashtë mujorit të parë të vitit 2019, Gjykata e Apelit sipas statistikave të siguruara nga kjo gjykatë janë zgjidhur 427 lëndë prej të cilave 368 lëndë janë vërtetuar, 46 janë kthyer në rivendosje në GjTh në Prishtinë, për një lëndë është hedhur ankesa ndërsa 12 lëndë janë zgjidhur në mënyrë të tjera.


7. NGARKESA ME LËNDË ADMINISTRATIVE NË GJYKATËN SUPREME

Gjykata Supreme e cila është instanca më e lartë në të cilën palët e pakënaqura me vendim të DÇA-së të Gjykatës së Apelit mund të shfrytëzojnë të drejtën për mjete të jashtëzakonshëm siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Kjo gjykatë numëron pak kërkesa të qytetarëve apo palëve që kanë shfrytëzuar mjetet e jashtëzakonshme.

Gjatë vitit 2018 janë zgjidhur 3 lëndë të çështjeve administrative të ushtruara përmes kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, e drejtë kjo që iu garantohet palëve me nenin 49 të LKA-së.

Në këtë gjykatë gjatë periudhës së vitit 2018 në bazë të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor janë zgjidhur 87 lëndë.



Grafika nr 5: Lëndët e zgjidhura gjatë vitit 2018 në Gjykatën Supreme.

Pra, nga këto të dhëna shihet se stabiliteti me numër të lëndëve administrative në Gjykatën Supreme është po thuajse më i madh se sa në Gjykatën e Apelit.

8. ANALIZA E RASTEVE DHE TRAJTIMI I TYRE NË DÇA NË GJTH NË PRISHTINË

IKD tanimë ka hyrë në vitin e gjashtë të monitorimit të KGJK-së, KPK-së, Gjykatave dhe Prokurorive të Republikës së Kosovës. Në kuadër të monitorimit të sistemit gjyqësor, përpos 7 Gjykatave Themelore, Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, IKD monitoron edhe në të gjithë degët e Gjykatave. Monitorimi i IKD-së shtrihet në të gjitha natyrat e lëndëve, siç janë penale, civile, administrative etj. Për të prezantuar të gjitha të gjeturat nga tereni, IKD raporton në baza ditore në portalin www.betimiperdrejtesi.com, ndërsa për paraqitjen e të dhënave specifike dhe statistikore për rastet, IKD në vitin e kaluar ka lansuar edhe platformën e monitorimit¹¹.

8.1. GJETJET E IKD-SË MBI DEPARTAMENTIN PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Sa i përket rasteve të natyrës administrative, IKD gjatë vitit 2018 dhe gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2019 ka mbledhur afërsisht 100 aktgjykime nga 133 seancave të monitoruara, të cilat kanë përfunduar në shkallë të parë.

Në këtë pjesë, IKD do të analizojë të gjeturat kryesore nga monitorimi sistematik i drejtësisë administrative, derisa në aneksin 1 të këtij raporti do të trajtohen edhe raste të përzgjedhura të proceseve gjyqësore administrative.

Pas një analize të thellë të këtyre aktgjykimeve IKD-ja ka gjetur se të njëjtat nuk përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm të rasteve, në atë mënyrë që palët dhe publiku realisht të kuptojnë dhe të binden se pse në një rast të caktuar Gjykata ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit.

“Dhënia e arsytimit adekuat për dënimin përfundimtar është e rëndësishë parësore. Arsyetimi dhe analizimi i qartë janë kërkesa thelbësore të vendimeve gjyqësore dhe një aspekt i rëndësishëm i së drejtës në gjykim të drejtë të paraparë në nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Cilësia e vendimeve gjyqësore varet kryesisht nga cilësia e arsytimit të tyre. Arsyetimi adekuat është domosdoshmëri e cila nuk duhet neglizhuar në interes të shpejtësisë”¹².

Aktgjykimet e rasteve të monitoruara tregojnë në mënyrë të shkurtër kthimin e një rasti në rivendosje në rastet kur aprovohet padia, duke mos u lëshuar në një arsyetim konkret dhe në rekomandime konkrete për organin administrativ që do të shqyrtojë rekomandimin e gjykatës kur rasti kthehet në rivendosje tek të njëjtat.

Sipas vlerësimit të IKD-së përmbledhja e atyre çka janë thënë në seancë nuk përbën arsyetim të një vendimi kur mungon arsyetimi i bazës mbi të cilën është refuzuar një padi nga kjo gjykatë.

Mundësia e lejuar me ligj që gjykatësit e këtij departamenti rastet t'i kthejnë në rivendosje, sipas IKD-së po iu mundëson atyre që të vendosin në mënyrë formale për të njëjtat pa dhënë arsyetim të plotë për refuzimin apo aprovimin e padive.

¹¹ IKD, PLATFORMA E MONITORIMIT TË GJYQËSORIT. (Shih www.ejudiciary.org). (Qasur së fundi më 9 shtator 2019).

¹² Udhëzues për Politikën Ndëshkimore. Gjykata Supreme. 15 shkurt 2018. f.198 (http://ëëë.oak-ks.org/repository/docs/Udhëzues_per_Politikën_Ndeshkimore_Shkurt_2018_346913.pdf). (Qasur për herë të fundit më 9 shtator 2019).

Gjykatësit e këtij departamenti në shumë pak raste vendosin në mënyrë meritore për një çështje pa e dërguar fillimisht rastin në rivendosje, duke bërë që shkalla e përgjegjësisë të jetë më e ulët.

Sipas të dhënave që IKD ka nxjerrë pas analizimit të aktgjykimeve aprovuese, është gjetur se 90% e këtyre aktgjykimeve janë aktgjykime sipas të cilave rasti kthehet në rivendosje në organin administrativ.

IKD vlerëson se kjo mënyrë se si veprojnë gjyqtarët, është burimi kryesor i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, pasi në këtë proces, zvarritja më e madhe e procedurës bëhet gjatë procedurës së konfliktit administrativ, veçanërisht nga GjTh në Prishtinë, me kthimin e rasteve në rivendosje.

Edhe pse ka kritika të vazhdueshme se organet administrative nuk po përfillin vendimet e GjTh në Prishtinë dhe vendosin përsëri për një rast në mënyrë identike, nuk është bërë asnjë hap në këtë drejtim që kjo dukuri të ndalet.

8.1.1. KOHËZGJATJA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE NË DEPARTAMENTIN PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Në DÇA të GjTh në Prishtinë sipas të dhënave të kësaj gjykate, kohëzgjatja e trajtimit të një rasti prej momentit kur padia paraqitet në gjykatë e deri në ditë kur merret vendimi nga e njëjta është 947 ditë për lëndët e Departamentit Administrativ, ndërsa 1189 ditë në Divizionin Fiskal.

Nga kjo mund të kuptojmë që një qytetarë për realizimin e të drejtës së tij përmes gjykatës, duhet të pres minimumi dy vite e gjysmë, ndërsa në rastet e gjykuara në Divizionin Fiskal duhet të presë mbi tri vite.

Ndonëse LKA-ja nuk ka të caktuar afatin kohor brenda të cilit një rast duhet të përfundojë në gjykatë, gjithmonë bazohet dhe vepron sipas parimin të efikasitetit që një lëndë të zgjidhet në kohë të arsyeshme duke mos përcaktuar afate kohore.

Legjislacioni i aplikueshëm në drejtësinë administrative përmban disa mospërputhje të dispozitave ligjore mes LKA-së dhe LPPA-së që po ashtu nuk sigurojnë zbatim efikas të procedurës administrative nga ana e gjykatës dhe me këtë edhe të mbrojtjes së të drejtave të individëve.


Sipas përgjigjes së gjykatës, prioritet në DÇAe kanë lëndët e vjetra dhe rendi i lëndëve shkon nga zgjidhja e lëndëve më të vjetra tek të rejat. Mirëpo IKD-ja ka hasur në një politikë diskriminuese dhe selektive të zhvilluar nga DÇA i GjTh në Prishtinë, e cila disa rasteve mediatike ndonjë bazë ligjore iu ka dhënë prioritet, në krahasim me rastet tjera që presin minimumi dy vite që padia e tyre të shqyrtohet.¹³

¹³ "Gjykata anulon vendimin e MPB-së me të cilin njëri nga gjashtë "Gylenistët" ishte deportuar nga Kosova". Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-anulon-vendimin-e-mpb-se-me-te-cilin-njeri-nga-gjashte-gylenistet-ishte-deportuar-nga-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 18 shtator 2019). "Rasti i "Gylenistëve", njëri prej tyre kërkon që MPB-ja të anulojë vendimin për revokimin e leje qëndrimit në Kosovë".

Lidhur me dhënien prioritet për disa nga rastet që do të trajtohen në vijim, IKD-ja ka kërkuar përgjigje mirëpo asnjëherë nuk ka marrë ndonjë informacion nga kjo gjykatë se mbi cilën bazë i kanë dhënë prioritet disa rasteve e disa rasteve jo.

Një kohëzgjatje kaq të madhe të procedurës nuk e kemi në DÇA të Gjykatës së Apelit. Për dallim nga DÇA i GjTh në Prishtinë, në DÇA të Gjykatës së Apelit kohëzgjatja e procedurës është 8 deri në 10 muaj.

Nëse kalkulojmë minimumet e kohëzgjatjes së një procedure administrative prej kohës së paraqitjes së padisë në Gjykatë e deri kur aktgjykimi të marrë formën e prerë (nëse ka ankesë) atëherë i bie të jetë 3 vite e 2 muaj. Nëse i shikojmë proceset si të ndara, atëherë del se këtë kohëzgjatje më së shumti i krijon GjTh e Prishtinës. Për këtë arsye, kjo Gjykatë, por edhe KGJK, duhet të bëjnë një strategji konkrete që të dalin nga kjo situatë, sipas të cilës Gjykata më e madhe në Republikën e Kosovës bëhet burim i vazhdueshëm i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore.




Grafika 6: Kohëzgjatja e rasteve në GjTh në Prishtinë.

Betimi për Drejtësi. 7 dhjetor 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-gylenisteve-njeri-prej-tyre-kerkon-qe-mpb-ja-te-anuloje-vendimin-per-revokimin-e-leje-qendrimit-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 18 shtator 2019).

Ndërsa sipas statistikave të siguruara nga monitorimi i IKD-së, paditë më të shpeshta në gjykatë gjatë kësaj periudhe të vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të vitit 2019 kanë qenë ndaj MPMS-së lidhur me kërkesat për pensione.

Ndërsa nuk mungojnë rastet edhe ndaj KPMSHCK, ku palët e pakënaqura me vendime lidhur me vendet e tyre të punës kanë kërkuar nga Gjykata të drejtat e tyre.

Padi të shumta janë bërë edhe ndaj Doganës së Kosovës dhe ATK-së, raste me të cilat merret divizioni fiskal në kuadër të DÇA-së



Grafika 7: Institucionet e paditura në DÇA.


Nga monitorimi sistematik në këtë departament, IKD ka gjetur se praktika e krijuar nga ana e gjykatës lidhur me vendosjen apo dhënien e verdiktit në çështje administrative është një formë e cila ndikon negativisht në administrimin e drejtësisë, e cila po ndikon në zvarritjen e rasteve. Në këtë mënyrë krijohen procedura të panumërta që nuk po arrijnë të përfundohen me vite.

Kjo për shkakun që në aktgjykimet në të cilat është aprovuar kërkesa e palëve të pakënaqura me vendime të institucioneve shtetërore, gjykata në shumicën e rasteve vendos që çështjen ta kthejë përsëri te organet administrative.

Në këtë mënyrë organet administrative në 90% të rasteve pothuajse vendosin njëjtë, duke bërë që pala përsëri për herë të dytë të bëjë padi në gjykatë. Nëse edhe në herën e dytë procedura zgjatë edhe 3 vite e 2 muaj të tjerë, atëherë kjo i bie se për një rast të vetëm, sistemit gjyqësor i janë

dashur mbi 6 vite për të vendosur, përjashto këtu kohëzgjatjen e procedurës administrative. Me fjalë të tjera, zgjidhja e një rasti mund të marrë deri në një dekadë.

Në anën tjetër, IKD në tabelën më poshtë do të paraqes në mënyrë grafike numrin e seancave të monitoruara në DÇA gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të vitit 2019, duke treguar sa seanca janë mbajtur dhe sa prej tyre janë shtyrë gjatë kësaj periudhe:



Grafika 7: Numri i seancave të mbajtura dhe të shtyra në DÇA të GjTh në Prishtinë.

Në LKA përcaktohet që “nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve”¹⁴. Kjo dispozitë i përshtatet edhe vetë natyrës së procedurës administrative, në mënyrë që të mos pengohet administrimi i mirë i drejtësisë, ndonëse jo në secilin rast, kjo mund të jetë në dobi të palës e cila mungon.

Dukuria e mos paraqitjes në seancë është dukuri jashtëzakonisht e shprehur në rastet kur të paditura janë organet shtetërore, e që përfaqësohen nga (ASh) që funksionon kuadër të (MD).

Mos pjesëmarrja e organeve shtetërore, të cilat shpesh edhe nuk sjellin as provat e nevojshme për rastet përkatëse tregon një neglizhencë të institucioneve për tu marrë me qytetarë që i atakojnë

¹⁴ Ligji për Konfliktet Administrative. Neni 41.2.

vendimet e tyre në procedura administrative. Thënë më ndryshe, kjo dukuri tregon mungesën e ASH-së për mbrojtjen e interesit publik.

Përpos seancave, IKD ka analizuar edhe përgjigjet në padi që i bëjnë këto institucione në raste në gjykatë e të cilat janë të njëjta vetëm ndryshon emri dhe mbiemri i paditësit. Në këtë mënyrë, ASH ka krijuar një praktikë “shabllone” për trajtimin e këtyre rasteve, e që një praktikë e tillë më së paku nënkupton mbrojtje efektive dhe efikase të interesit publik.

Për më tepër, në një nga rastet e monitoruara, IKD ka gjetur se ASH kishte dërguar përgjigje në padi për një qytetare duke iu referuar një personi tjetër, e jo personit në fjalë¹⁵.

Për të gjitha këto gjetje, IKD ka tentuar të marrë përgjigje nga Avokatura Shtetërore për më shumë se një vit. Mbi gjetjet e IKD-së, përkundër kërkesave të shumta të dërguara vazhdimisht, ASH nuk ka kthyer përgjigje konkrete.

IKD vlerëson se mënyra e veprimit të ASH-së në këto raste është plotësisht e papranuar. Sipas nenit 8 të ligjit Nr. 04/L-157 për Avokaturën Shtetërore, *“Avokatura shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative në pajtim me ligjin”*. Mbi bazën e këtij statusi, ASH duhet të mbrojë në mënyrë efektive dhe efikase organet shtetërore në këto procedura si dhe duhet ta trajtojë secilin rast varësisht prej specifikave të tij. Lidhur me punën e ASH-së, emisioni “Betimi për Drejtësi” më 23 mars 2019 kishte realizuar intervistë me Avokatin Shtetëror, Sami Istrefi¹⁶.

Gjatë kësaj interviste, Istrefi thotë se ASH përballët me një numër jashtëzakonisht të madh të lëndëve, ku sipas tij, gjatë vitit 2018 kishin pasur në punë gjithsej 3448 lëndë, ku 1510 prej tyre ishin lëndë në procedurë të konfliktit administrativ. Sipas Istrefit, ky numër është i papërballueshëm përprah faktit se në ASH veprojnë vetëm 5 avokatë.

¹⁵ MPMS-ja ngatërron paditësen, obligohet që sërish të paraqes provat dhe përgjigjen në padi. Betimi për Drejtësi. 5 prill 2018. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mpms-ja-ngaterron-paditesen-obligohet-qe-serish-te-paraqes-provat-dhe-pergjigjen-ne-padi/>). (Qasur për herë të fundit më 9 shtator 2019).

¹⁶ “Avokatura shtetërore”. 23 mars 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/emisionet/avokatura-shteterore/>). (Qasur për herë të fundit më 18 shtator 2019).

8.1.2. “PING PONGU” ME RASTET NË DREJTËSINË ADMINISTRATIVE

Siç u përmend edhe më lartë, shumë shkallëshmëria, mos zgjidhja e lëndëve në kohë të arsyeshme, “shëtitja” e palëve nga një organ në tjetrin për marrje të një përgjigje ka ndikuar në krijimin e një lloj “Ping Pongu” me lëndët administrative.

Kjo më së shumti është e shprehur në kthimin e lëndëve nga DÇA i GjTh në Prishtinë në organin administrativ të shkallës së dytë.

LKA përcakton se “Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ”¹⁷.

Por, përkundër kësaj, ky ligj ka përcaktuar edhe se “Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”¹⁸.

Në këtë dy situata, ideja e të cilave është që në favor të administrimit të mirë të drejtësisë gjykatësit ti kenë duart e lira, të njëjtit kanë zgjedhur një situatë sipas të cilës lëndët kryhen më shpejtë, por nuk bëhet fjalë për administrim të mirë të drejtësisë. Kjo për arsye se nga monitorimi sistematik, IKD ka gjetur se gjyqtarët në 90% të rasteve veprojnë sipas situatës së parë, përkatësisht kthejnë rastin në organin administrativ, dhe nuk nxjerrin aktgjykim sipas të cilit do të vendosnin mbi çështjen administrative në mënyrë meritore. Në këtë situatë, palës i duhet të kthehet përsëri në organin administrativ të shkallës së dytë, dhe potencialisht, përsëri të fillojë nga zero konfliktin administrativ në DÇA të GjTh në Prishtinë, dhe potencialisht ky proces të zhvillohet edhe në DÇA të Gjykatës së Apelit. Përpos kësaj, sipas vetë gjykatësve të këtij departamenti, vendimet e organeve shtetërore janë pothuajse identike edhe pas udhëzimeve të gjykatës se çfarë duhet të veprojnë.

Në këtë mënyrë, është pikërisht ky veprim i gjyqtarëve, si i vetëm, që në start e dyfishon kohën e trajtimit të një lënde. Për më tepër, padia në konflikt administrativ për herë të dytë, konsiderohet lëndë e re, pa asnjë lloj prioriteti.

Në anën tjetër, me këtë mënyrë të veprimit, Gjyqtarët vetëm sa i ikin përgjegjësisë së tyre si akterët kryesorë për vënien e drejtësisë administrative, duke i'a lënë këtë në kompetencë organit administrativ.

¹⁷ Ligji për Konfliktet Administrative, neni 43.2.

¹⁸ Po aty, neni 46.4.

IKD vlerëson se Gjyqtarët e DÇA duhet të kujdesen në secilin rast që të ketë administrim të mirë të drejtësisë, mënyra e kryerjes së të cilave raste, si tërësi, paraqet vetë pasqyrën e mirë/keq administrimit të drejtësisë. Sipas IKD-së, për këtë situatë tanimë të krijuar, sipas të cilës sistemi gjyqësor nuk garanton një mjet efikas juridik në fushën e drejtësisë administrative, përgjegjësia primare bie tek vetë Gjyqtarët.

Në anën tjetër, mbi këto defekte të funksionimit të drejtësisë administrative, duhet të veprojë KGJK, përkatësisht Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve. Vetë ideja e konceptit të vlerësimit të performancës është përmirësimi i sistemit gjyqësor, duke larguar veprimet dhe praktikat të cilat ndikojnë negativisht në administrimin e mirë të drejtësisë. Andaj, ky komision duhet të veprojë në mënyrë meritore, efikase dhe efektive, në mënyrë që të parandalojë praktika të tilla të cilat në instancë të fundit, dëmtojnë interesin juridik të qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke shkelur të drejtat e tyre kushtetuese.

IKD, në vazhdim do të pasqyroj analizën e rasteve të monitoruara gjatë vitit 2018 dhe gjashtë mujorit të vitit 2019 .

Analiza e këtyre rasteve do të bëhet që nga paraqitja e padisë në gjykatë deri te caktimi i seancës nga gjykata dhe më pas vendimi i kësaj gjykate lidhur me padinë.

Nga rastet e monitoruara kemi përzgjedhur disa nga rastet e përfunduara nga kjo gjykatë ku organe të paditura kanë qenë institucionet shtetërore.

8.1.3. 200 LËNDËT “STAND-BY” NGA GJYKATA E APELIT PËR MË SHUMË SE 5 VITE

Sistemi Gjyqësor në Republikën e Kosovës ishte ri konstruktuar në masë të konsiderueshme me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat. Bazuar në nenin 43 të këtij ligji, pjesa më e madhe e këtij ligji ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013¹⁹.

Gjatë fazës transitorie në mes të sistemit të vjetër organizativ të Gjykatave me sistemin sipas ligjit të ri, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës kishte në punë rreth 200 lëndë administrative të qytetarëve apo paditësve të tjerë ndaj ATK dhe Doganës së Kosovës

Sikurse në secilin ligj të kësaj natyre, edhe Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat ka paraparë dispozitat kalimtare, për rastet të cilat tanimë janë në proces.

Përkritazi me këto raste, Ligji në fjalë ka përcaktuar shprehimisht se *“Të gjitha lëndët të cilat më 31 dhjetor të vitit 2012 janë lëndë të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme, Gjykatës së Qarkut apo Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje dhe nuk janë zgjidhur me një vendim të formës së prerë, më 1 janar të vitit 2013 trajtohen si lëndë të Gjykatës së Apelit”*²⁰.

Mbi këto bazë, të gjitha lëndët administrative të shkallës së dytë të cilat kishin qenë duke u trajtuar nga Gjykata Supreme ishin transferuar në DÇA të Gjykatës së Apelit.

¹⁹ Shënim: Ndryshimet në këtë ligj janë të trajtuara edhe në pjesën e kornizës ligjore të këtij raporti.

²⁰ Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat. Neni 39.1.

Pjesë e këtyre lëndëve ishin edhe rreth 200 ankesa të qytetarëve apo paditëse ndaj ATK, DK-së dhe subjekteve të tjera të cilat kanë mbetur të pazgjidhura pasi që Bordi i Pavarur për Shqyrtimin e Ankesave (BPRA), ishte shpallur si jo funksional nga dhjetori i vitit 2014.

Gjykata e Apelit për hiç më pak se rreth gjashtë vite pa ndonjë arsye dhe bazë ligjore ka mbajtur në sirtar rreth 200 lëndë që ishin kompetencë e DÇA. Si arsyetim për këtë prolongim mbi gjysmë dekadë, Gjykata e Apelit kishte përdorur faktin e shuarjes së BPRA-së, i cili shërbente si shkallë e dytë që vendoste mbi ankesat e bizneseve ndaj vendimeve të ATK-së dhe DK-së.

Përballë kësaj situate të krijuar, Gjykata e Apelit kishte heshtur për 5 vite radhazi duke mos marrë as edhe një veprim të vetëm për këto lëndë.

Veprimi i parë i kësaj Gjykate ishte paraqitur më 4 dhjetor 2017, por jo në drejtim të lëndëve, por në drejtim të sqarimit të kësaj situate. Më 4 dhjetor 2017, Gjykata e Apelit kishte kërkuar nga Gjykata Supreme nxjerrjen e një mendimi juridik mbi këtë situatë, kërkesë të cilën Gjykata e Apelit e kishte përsëritur edhe më 19 janar 2018.

Më 15 shkurt 2018, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës kishte konstatuar se në rastin konkret, nuk ka bazë ligjore për dhënie të mendimit juridik.

“Gjykata Supreme në seancën e mbajtur më datë 15 shkurt 2018, në rend dite ka pasur edhe shqyrtimin e kërkesës së Gjykatës së Apelit, të datës 19 janar 2018, për dhënien e mendimit juridik, lidhur me çështjen në fjalë. Gjykata Supreme nxjerr (jep) Mendime Juridike, me qëllim të unifikimit të zbatimit unik të ligjeve, kur dispozitat e caktuara ligjore nuk aplikohen njëjtë nëpër gjykatat e Kosovës. Në rastin konkret, nuk kemi një situatë të tillë, për këtë arsye, Gjykata Supreme, nuk mund të jep Mendim Juridik, siç parashtrohet kanë kërkuar. Ndaj, në seancën e 15 shkurtit, gjyqtarët kanë diskutuar përkritazi me këtë kërkesë, duke u pajtuar se nuk mund të jepet mendim juridik në një rast të tillë”²¹.

As pas gati 1 vit pas refuzimit të Gjykatës Supreme për dhënien e një mendimi juridik përkritazi me këtë situatë Gjykata e Apelit nuk ka ndërmarrë veprime në këto lëndë. Tek në fillim të vitit 2019, Gjykata e Apelit i ka kthyer këto lëndë në rivendosje në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përkatësisht në Divizionin Fiskal të DÇA-së.

IKD vlerëson se për të gjithë këtë proces, KGJK duhet të mbajë përgjegjësinë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, të cilët kanë pasur detyrim ligjor që brenda një afati të arsyeshëm kohor të ndërmarrin veprimet e nevojshme lidhur me këtë situatë. Kjo përgjegjësi duhet të adresohet edhe përmes procesit të vlerësimit të performancës por edhe përmes procedurave disiplinore, nga autoritetet kompetente sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.²²

²¹ Zyra për informim. Gjykata Supreme. 14 mars 2018.

²² Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Neni 9.1. "Personat fizik dhe juridik mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori lidhur me ndonjë pretendim për shkelje disiplinore tek autoritetet vijuese (në tekstin e mëtejshëm: "Autoriteti Kompetent"): 1.1. Kryetari i Gjykatës Themelore dhe të Apelit në të cilën shërben gjyqtari për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të atij gjyqtari; 1.2. Kryetari i

Në rastin konkret, kemi dy dështime skandaloze të Gjykatës së Apelit. Fillimisht, është i papranueshëm argumenti se Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit nuk dinë si të veprojnë në këto raste. Është parim i njohur në drejtësi se Gjyqtari e njeh ligjin (*jura novit curia*). Në anën tjetër, pritja për 5 vite për të kërkuar thjeshtë mendim juridik nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës tregon jo seriozitet dhe përgjegjësi totale të Gjykatës së Apelit përkitazi me pritjen e palëve përmbi gjysmë dekadë.

Për këto arsye, IKD vlerëson se nëse KGJK i trajton këto raste symbyllurazi, mungesa e llogaridhënies dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve, tanimë pothuajse e instaluar në sistemin gjyqësor, do të ketë një progres të jashtëzakons\

Gjykatës Supreme për sa i përket pretendimeve për shkeljeve disiplinore të Kryetarëve të Gjykatave Themelore dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit; 1.3. Këshilli Gjyqësor i Kosovës për sa i përket pretendimeve për shkelje disiplinore të Kryetarit të Gjykatës Supreme”.

9. ANNEX 1: ANALIZË E DETAJUAR E RASTEVE KARAKTERISTIKE ADMINISTRATIVE TË PËRFUNDUARA ME AKTGJYKIM TË FORMËS SË PRERË

1. Rasti i Qamil Elshanit ndaj MPMS

(Nga data e parashtrimit të padisë së parë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 2092 ditë)

Gjykatëse: Luljeta Maxhuni

Paditës: Qamil Elshani

E paditur: Minsitria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të MPMS-së

Data e parashtrimit të padisë: 31.03. 2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 19.09. 2018

Aktgjykimi: Aprovues (meritor)
Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

Qamil Elshani kishte bërë kërkesë në MPMS që t'i njihet e drejta në pension për persona me aftësi të kufizuara. Këtë kërkesë, në vitin 2012, MPMS ia kishte refuzuar me arsyen se ai nuk i plotëson kushtet.

Pas kësaj, ai kishte paraqitur padi në gjykatë në janar të vitit 2013, përderisa gjykata, respektivisht DÇA i GjTh në Prishtinë kishte vendosur në vitin 2016 që atij t'i aprovoj kërkesën. Me aktgjykimin në fjalë, DÇA i GjTh në Prishtinë lëndën e kishte kthyer në rivendosje, ku ishin paraqitur edhe rekomandimet për organin administrativ.

Përkundër rekomandimit të gjykatës, organi administrativ sërish kishte vendosur që paditësit t'ia refuzoj kërkesën, duke bërë që Elshani sërish të iniciante konflikt administrativ për të njëjtin rast dhe me të njëjtat fakte.

Herën e dytë në prill të vitit 2018, gjykata kishte ftuar ekspertët që të vërtetonin gjendjen e paditësit për të parë se i njëjti a i plotëson kriteret për pension për persona me aftësi të kufizuar.

Sipas aktgjykimit të datës 19 shtator 2018, pasi që ekspertët kishin deklaruar se paditësi është i paaftë dhe ka probleme të mëdha shëndetësore dhe nuk është në gjendje të punoj, gjykata kishte vendosur që të aprovonte kërkesën e paditësit në mënyrë meritore.

Me këtë aktgjykimi gjykata kishte anuluar vendimin e MPMS-së të datës 9 mars 2016 dhe vendimin e shkallës së parë, i cili ishte i vitit 2012.

Në aktgjykim, ishte obliguar e paditura MPMS-ja që paditësit t’ia njoh të drejtën në pension për persona me aftësi të kufizuar si dhe t’i bëj kompensimin për periudhën kohore prej kur i kishte ndërprerë këtë pension.

Elshanit, kjo ministri ishte e obliguar t’i kompensonte pensionin mujor nga 3 dhjetori 2012 në vlerë prej 40 euro çdo muaj deri në mars të vitit 2014. Më pas të njëjtit do t’i paguante nga prilli 2014 e deri në fund shumë prej 75 euro duke llogaritur edhe kamatën ligjore.

Nga kjo rezulton se paditësi për realizmin e të drejtës së tij në tërësi iu është dashur të pres më shumë se 5 vite pasi që kthimi në rivendosje i rastit të tij i kishte shkaktuar të njëjtit pritje edhe më të gjatë, duke e detyruar të inicioje përsëri padi në gjykatë.

Lidhur me këtë rast nuk kishte pasur ankesë në Gjykatën e Apelit.

2. Rasti i Ish-Ambasadorit Akan Ismajli kundër AKK-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 630 ditë)

Gjykatësi : Hajriz Hoti

Paditës: Akan Ismajli

E paditur: Agjencia Kadastrale e Kosovës

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës

Padia e parashtruar më 31/05/2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 20/02/2018

Aktgjykimi: Aprovues (Rivendosje)**Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit:** Nuk ka pasur ankesë

Ish-Ambasadori i Republikës së Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), Akan Ismaili, kishte paditur Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me pretendimin se ajo me vendimin e saj, i kishte refuzuar atij ankesën përmes së cilës kërkonte regjistrim të pronësisë në dy ngastra tokësore²³.

Këto dy ngastra tokësore, Ismaili, sipas padisë së parashtruar më 31 maj 2016, i kishte fituar me anë të një kontrate për borxh, të cilën ai e ka pasur me të ndjerin Dino Asanaj, i cili, siç thuhet në padi, i kishte marrë atij hua në vlerë prej 400,000 mijë euro, por këtë shumë nuk kishte arritur ta paguante pasi që Asanaj kishte vdekur.

Më 20 shkurt 2018 gjykata ka marrë vendim që ish-ambasadorit Ismajli, t'i aprovojë këtë kërkesë duke e kthyer çështjen në rivendosje te AKK-ja.

Sipas aktgjykimit, AKK-ja në vendimin e saj me të cilin i kishte refuzuar kërkesën Ismajlit, kishte pasur të meta dhe shkelje thelbësore të ligjit për procedurën administrative.

Në këtë rast gjykatës i janë dashur dy vite që të shqyrtoj padinë e paditësit Ismajli e që të vendos në shkallë të parë lidhur me kërkesën e tij.

Më 20 shkurt 2018 është mbajtur seancë për këtë rast i cili pas administrimit të provave ka përfunduar në po këtë datë.

Ndaj vendimit të shkallës së parë nuk ka pasur ankesë nga asnjëra palë, ndërsa rasti është kthyer në rivendosje në organin administrativ, respektivisht në Agjencinë Kadastrale të Kosovës.

²³ "Ish-ambasadori i Kosovës në SHBA padit AKK-në për mos regjistrim të pronësisë". Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/ish-ambasadori-i-kosoves-ne-shba-padit-akk-ne-per-mos-regjistrim-te-pronesise/>). (Qasur për herë të fundit më 10 shtator 2019).

3. Rasti i Sabrenaze Morinës ndaj MSh-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 607 ditë)

Gjykatës: Hajriz Hoti

Paditës: Sabrenaze Morina

E paditur: Ministria e Shëndetësisë

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit

Data e paraqitjes së padisë: 24/06/2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 21/02/2018

Aktgjykimi: Refuzues

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

Gjykata gjatë vitit të kaluar, po ashtu vendosi në rastin e paditëses Sabrenaze Morina, e cila kishte paditur Ministrinë e Shëndetësisë me pretendimet se kjo ministri asaj si pronare e IPSH “Optika Syri”, i kishte ndaluar ushtrimi i veprimtarisë pasi që gjatë inspektimit në këtë subjekt ishin gjetur gazra sterile, gazra të përdorura dhe shpuese të hyra në përdorim dhe të hedhura, ndërsa ky vend shërbente vetëm për shitjen e syzeve për pacient²⁴.

Mirëpo, gjykata padinë e Morinës kishte vendosur që ta refuzojë si të pabazuar pasi që sipas këtij aktgjykimi paditësja kishte ushtruar veprimtarinë e saj në kundërshtim me ligjin.

Morina kishte paraqitur padi më 24 qershor 2016, kurse rasti i saj përfundoi më 21 shkurt 2018 që i bie se gjykatës së shkallës së parë i janë dashur një vit e tetë muaj që të zgjidh rastin.

Pas pranimit të vendimit të Gjykatës Themelore, paditësja nuk ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, duke bërë vendimin e shkallës së parë të plotfuqishëm.

²⁴ "Paditësi kërkon anulimin e vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë që ia ndaloi ushtrimin e veprimtarisë". Betimi për Drejtësi. 21 shkurt 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/paditesi-kerkon-anulimin-e-vendimit-te-ministrise-se-shendetesise-qe-ia-ndaloi-ushtrimin-e-veprimtarise/>). (Qasur për herë të fundit më 10 shtator 2019)

4. Rasti i Sinan Vershevcit kundër MPMS

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 885 ditë)

Gjykatëse: Luljeta Maxhuni

Paditës Sinan Vershevc

E paditur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Objekt shqyrtimi: Anulim vendimi

Data e paraqitjes së padisë: 06/06/2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 8/11/2018

Aktgjykimi: Aprovues (rivendosje)**Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit:** Nuk ka pasur ankesë

Karakteristikë ishte një vendim i marrë lidhur me njohjen e pensionit për paditësin Sinan Vershevc, i cili kishte paraqitur padinë një vit pas kalimit të afatit, ndërsa Gjykata Themelore i ka aprovuar kërkesën duke e kthyer çështjen në rivendosje te MPMS²⁵.

Ndonëse padia e Vershevcit ndaj MPMS-së ishte paraqitur më 6 qershor 2016, vendimi i shkallës së dytë i marrë nga MPMS, ishte i 29 qershorit të vitit 2015. Sipas LKA-së, pala ka afat 30 ditë që të parashtoj padi në Gjykatë, nga data kur e pranon vendimin e shkallës së dytë në procedurë administrative.

Sipas LKA-së, një padi mund të pranohet nga gjykata nëse është paraqitur pas afatit vetëm në rastin kur “padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por organit tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e mos dijes apo e gabimit të hapur të paraqitësit”²⁶. Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me këtë situatë.

Sidoqoftë, padia e Vershevcit është aprovuar pasi që siç thuhet në aktgjykimin e përpiluar nga ana e gjykatës Luljeta Maxhuni, MPMS, kur kishte vendosur lidhur me kërkesën e Vershevcit kishte marrë për bazë një ligj të shfuqizuar dhe nuk kishte aplikuar dispozitat e ligjit që kishte qenë në fuqi.

Sido që të jetë ndaj vendimit të shkallës së parë, palët në këtë konflikt administrativ nuk kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, ndërsa pritet që vendoset përsëri për këtë rast nga MPMS-ja pasi që rasti është në rivendosje.

²⁵ "Paditësi kundërshton vendimin e MPMS-së, kërkon t'i njihet e drejta e pensionit". Betimi për Drejtësi. 8 nëntor 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/paditesi-kundershton-vendimin-e-mpms-se-kerkon-ti-njihet-e-drejta-e-pensionit/>). (Qasur për herë të fundit më 10 shtator 2019).

²⁶ Ligji për Konfliktet Administrative. Neni 28.1

5. Rasti i Jakup Sermaxhaj ndaj KPMSHCK-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 593 ditë)

Gjykatës: Hajriz Hoti

Paditës: Jakup Sermaxhaj

E paditur: KPMSHCK

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit

Data e paraqitjes së padisë: 05/10/2016

Data e vendosjes në GjTh në Prishtinë: 22/02/2018

Aktgjykimi: Refuzues

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: 21/05/2018

Aktgjykimi: Refuzues Jakup Sermaxhaj, e kishte quajtur të paligjshëm vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSHCK), me anë të cilit i ishte refuzuar ankesa për ndërrimin e vendit të punës nga “zyrtar i lartë i prokurimit” në “zyrtar i lartë i pagave” në Policinë e Kosovës²⁷.

Pas ndërrimit të njëpasnjëshëm të vendit të punës nga ana e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës, paditësi Sermaxhaj, i pakënaqur me këto ndërrime, kishte paraqitur ankesa në këtë këshill dhe pastaj padi në gjykatë më 5 tetor 2016, duke kërkuar kthimin në pozitën e parë si “zyrtar i lartë i prokurimit” dhe anulimin e vendimit të këshillit me të i ishte refuzuar ankesa.

Ndërsa, gjykata pas analizimit të padisë dhe shkresave të lëndës kishte vendosur që të njëjtit t'i refuzojë kërkesën si të pa bazuar.

Jakup Sermaxhaj kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit më 4 prill 2018, ndërsa kjo gjykatë më 21 maj 2018 kishte pranuar lëndën sipas ankesës dhe ankesën e palës e kishte refuzuar duke vërtetuar vendimin e GjTh në Prishtinë.

Palës iu është dashur që vetëm për vendim të shkallës së parë të pres një vit e katër muaj, ndërsa në Gjykatën e Apelit i njëjti ka marrë përgjigje për një kohë më të shkurtë që është përafërsisht tre muaj.

²⁷ "Paditësi kërkon anulimin e vendimit të KPMSHCK-së, thotë se është i paligjshëm". Betimi për Drejtësi. 22 shkurt 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/paditesi-kerkon-anulimin-e-vendimit-te-kpmschck-se-thote-se-eshte-i-paligjshem/>). (Qasur për herë të fundit më 10 shtator 2019).

6. Rasti i Komunës së Prishtinës ndaj KPMSHCK-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 423 ditë)

Gjykatës: Hajriz Hoti

Paditës: Komuna e Prishtinës

E paditur: KPMSHCK

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit

Data e paraqitjes së padisë: 27/12/2016

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 23/02/2018

Aktgjykimi: Refuzues

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

Komuna e Prishtinës e cila pretendonte se KPMSHCK, nuk kishte kompetencë në vendosje të anulimit të procedurave për rekrutimin e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve për shkolla të ndryshme në kryeqytet, kishte paraqitur padi në gjykatë²⁸.

Në janar të vitit 2018, padia e Komunës ishte shqyrtuar nga Gjykata, ku ishte kërkuar që të anulohet vendimi i këshillit lidhur me anulimin e procedurës për zëvendës drejtor.

Mirëpo, sipas aktgjykimit të marrë nga kjo gjykatë, KPMSHCK, kishte pasur të drejtë të anulojë atë procedurë andaj kërkesa e Komunës së Prishtinës është refuzuar si e pabazuar.

Nga paraqitja e padisë e derisa rasti ka marrë verdikt nga shkalla e parë kanë kaluar 1 vit e një muaj, ndërsa palët nuk kanë parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

²⁸ "Komuna e Prishtinës thotë se KPMSHCK-ja s'kishte kompetencë të anulonte konkursin për drejtorë të shkollave. Betimi për Drejtësi. 24 janar 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/komuna-e-prishtines-thote-se-kpmschck-ja-skishte-kompetence-te-anulonte-konkursin-per-drejto-re-te-shkollave/>). (Qasur së fundi më 10 shtator 2019).

7. Rasti i Komunës së Graçanicës ndaj KPMSHCK-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 1269 ditë)

Gjykatëse: Lirije Maksutaj

Paditës: Komuna e Graçanicës

E paditur: KPMSHCK

Objekt shqyrtimi: Anulim vendimi

Data e paraqitjes së padisë: 20/04/2015

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 19/01/2018

Aktgjykimi: Refuzues

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: 10/10/2018

Aktgjykimi: Refuzues

Komuna e Graçanicës kishte paditur KPMSHCK, me pretendimet se ky këshill nuk ka respektuar rregullat procedurale kur ka vendosur ta kthejë në punë Snezhana Krstiq²⁹.

Pasi që sipas kësaj komune, Snezhana Krstiq ishte larguar nga puna për shkak të shkeljeve disiplinore nga ana e Komunës së Graçanicës, kurse këshilli kishte marrë vendim pas ankesës së Krstiq që atë ta kthejë në punë, pasi që sipas këtij këshilli, vendimi nga komisioni disiplinor ishte bërë pas afatit të caktuar ligjor.

Mendim të njëjtë me komunën nuk ndau gjykata e cila refuzoj këtë kërkesë ku edhe në këtë rast i dha të drejtë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, duke refuzuar plotësisht kërkesën e Komunës së Graçanicës dhe duke lënë në fuqi vendimin e këshillit.

Ndaj vendimit të Themelores, Komuna e Graçanicës kishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit më 7 shkurt 2018, mirëpo edhe Gjykata e Apelit me aktgjykimin e datës 10 tetor 2018 kishte vendosur që palës t'i refuzoj ankesën.

Nga pranimi i padisë deri në marrjen e vendimit nga ana e shkallës së parë kanë kaluar 2 vite e nëntë muaj. Për vendimin e shkallës së dytë kjo Komunë ka pritur nëntë muaj që të marrë vendimin e plotfuqishëm.

²⁹ "Komuna e Graçanicës kërkon anulimin e vendimit të KPMSHCK-së për kthimin në punë të zyrtares së përjashtuar". Betimi për Drejtësi. 19 janar 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/komuna-e-gracanices-kerkon-anulimin-e-vendimit-te-kpmshck-se-per-kthimin-ne-pune-te-zyrtares-se-perjashtuar/>).

8. Rasti i Adelina Strellcit ndaj MPB-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 859 ditë)

Gjykatëse: Lirije Maksutaj

Paditës: Adelina Strellci

E paditur: Ministria e Punëve të Brendshme

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit

Data e paraqitjes së padisë: 18/06/2016

Data e vendosjes në Gjykatën Themelore: 25/10/2018

Aktgjykimi: Refuzues **Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit:** Nuk ka pasur ankesë

Adelina Strellci ka paditur Ministrinë e Punëve të Brendshme duke kërkuar ndërrimin e prindërve të saj në librat amë, duke thënë se ata që ishin të shënuar më parë ishin axha dhe gruaja e axhës së saj.

Sipas padisë në kohën kur kishte lindur paditësja Adelina Strellci, Kosova kishte qenë nën regjimin e Serbisë dhe nëna e saj për të lindur në spital në Mitrovicë duhej të posedonte librezë shëndetësore, por ajo nuk e kishte.

Andaj, nëna e tani paditëses kishte marrë librezën e kunatës së saj, kurse kur vajza e saj kishte lindur ishte shënuar në emër të xhaxhait të saj dhe gruas së tij.

Mirëpo, kjo gjë, sipas paditëses, nuk ishte vërejtur deri në momentin kur paditësja, pasi që është shpërngulur në Kanada, ka ardhur në Kosovë për tu fejuar e kishte kuptuar se ajo figuron si vajza e dikujt tjetër, e jo e prindërve të saj biologjik.

Andaj me këtë kërkesë ajo iu është drejtuar gjykatës, mirëpo gjykata më 25 tetor 2018, ka vendosur që kërkesën e saj ta refuzojë, pasi që sipas gjykatës kjo padi ishte e pabazuar.

Që nga paraqitja e padisë deri në marrjen e vendimit nga shkalla e parë, kanë kaluar 1 vit e katër muaj, lidhur me këtë rast palët nuk kishin paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit.

9. Rasti i “BAUMETAL” ndaj Doganës së Kosovës

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 1160 ditë)

Gjykatës: Krenar Berisha

Paditës: Baumetal

E paditur: Dogana e Kosovës

Objekt shqyrtimi: Anulim vendimi të Doganës së Kosovës

Data e paraqitjes së padisë: 09/01/2015

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 14/03/2018

Aktgjykimi: Aprovues (rivendosje)

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

Aktgjykimi: Aprovues (rivendosje)

Kompania “Baumetal”, më 9 janar të vitit 2015, kishte ushtruar padi kundër Doganës së Kosovës, me pretendimet se iu ishte ngarkuar pagesë shtesë për transportimin e mallrave në vlerë prej 2950 euro³⁰.

Përmes kësaj padie, kjo kompani kishte kërkuar anulimin e vendimit të marrë nga ana e Doganës së Kosovës, për të paguar mjete shtesë për kamionët e transportit. “Baumetal”, e cila merret me transportimin dhe furnizimin e kompanive vendore me tulla nga Belgjika dhe Gjermania, ka thënë se vlera e llogaritur nga Dogana për pagesë të transportit deri në 2950 euro, ishte gati e barabartë me shumën e vetë mallit të ngarkuar në kamion.

Në bazë të kësaj kërkesë, gjykata në mars të vitit 2018 kishte vendosur që “Baumetal”, t’i aprovojë kërkesën dhe lëndën e ktheu në rivendosje në Doganën e Kosovës.

Për të marrë verdikt nga shkalla e parë që nga data e paraqitjes së padisë deri në përfundim gjykatës iu janë dashur një vit e 10 muaj që lëndën ta marrë në trajtim dhe të vendos për të.

Për këtë rast në Gjykatën e Apelit nuk ka pasur ankesa nga palët.

³⁰ "Paditësi kërkon anulimin e vendimit të Doganës së Kosovës për shpenzimet e transportit". Betimi për Drejtësi. 14 mars 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/paditesi-kerkon-anulimin-e-vendimit-te-doganes-se-kosoves-per-shpenzimet-e-transportit/>). (Qasur së fundi më 10 shtator 2019).

10. Rasti i “ABI SHPK” ndaj Doganës së Kosovës

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 1339 ditë)

Gjykatës: Rexhep Gashi

Paditës: “Abi” SHPK

E paditur: Dogana e Kosovës

Objekt Shqyrtimi: Anulimi i vendimit të Doganës së Kosovës i datës 20 maj 2015

Data e paraqitjes së padisë: 14/07/2015

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 14/03/2019

Aktgjykimi: Aprovues (rivendosje)

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

Paditësi “Abi”, SHPK, nga Prizreni kishte paraqitur padi më 14 korrik 2015 ndaj të paditurës Dogana e Kosovës duke kërkuar anulimin e vendimit të datës 20 maj 2015 me të cilin dogana sipas tij kishte bërë shkelje të dispozitave ligjore.

Sipas padisë, Dogana e Kosovës kishte dëmtuar tani paditësin në shumë prej 1,311.25 euro sipas rivlersimit të mallit andaj i njëjti, i pakënaqur me këtë vendim, kishte paraqitur ankesë së pari në Doganën e Kosovës, mirëpo pasi që kishte marrë përgjigje negative i njëjti kishte iniciuar konflikt administrativ.

Në seancën e mbajtur më 14 mars 2019 paditësi në fjalën përfundimtare kishte kërkuar që padia të aprovohet si e bazuar dhe kishte kërkuar anulimin e vendimit të datës 20 maj 2015, të Doganës së Kosovës, ndërsa gjykata pas analizimit të provave kishte marrë aktgjykim që të aprovoj kërkesën e paditësit “Abi” SHPK, si të bazuar dhe rastin e kishte kthyer sërish në rivendosje në Doganën e Kosovës.

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, organi administrativ në këtë rast Dogana e Kosovës, obligohet që në rishqyrtim të rastit të deklarohet lidhur me provat që ishin administruar në gjykatë siç kishin qenë pro fatura e mallit, transaksioni bankar i paditësit në mënyrë që të shoh se të njëjtat a kishin qenë në përputhje me Udhëzimin Administrativ 11/2009 të Doganës së Kosovës.

Lidhur me këtë gjykata ka obliguar të paditurën që të rishikojë edhe një herë ngarkesën tatimore që i ka vënë paditësit në shumë prej 1,311.25 euro dhe të vendos për rastin.

Ndaj vendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, palët nuk kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, ndërsa që nga data kur padia është paraqitur e derisa ka marrë verdiktin nga kjo shkallë kanë kaluar tri vite e tetë muaj.

11. Rasti i “FILA LUXENMBOURG” ndaj MTI-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 1250 ditë)

Gjykatëse: Arjeta Sadiku

Paditës: “Fila Luxenmbourg”

E paditur: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

Objekt Shqyrtimi: Anulimi i vendimit të MTI-së, i datës 23 tetor 2015

Data e paraqitjes së padisë: 20/11/2015

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 23/04/2019

Aktgjykimi: Aprovues (rivendosje)

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

“Fila Luxenmbourg” kishte paraqitur padi më 20 nëntor 2015 ndaj vendimit të MTI-së të datës 23 tetor 2015, me të cilin iu ishte refuzuar ankesa për mos njohje të drejtës së përparësisë për markë tregtare.

Duke konsideruar se vendimi ishte në kundërshtim me ligjet e aplikueshme dhe se i njëjti ishte i pavlefshëm ishte paraqitur padia në gjykatë ku më 23 prill të vitit 2019, derisa pas gati 4 viteve është marrë vendimi nga gjykatësja Sadiku e cila ka aprovuar kërkesën e paditësit.

Më 23 prill 2019 ky rast është kthyer në rivendosje në MTI, me arsyen se vendimi përmban shkelje të dispozitave ligjore, sepse paditësi thuhet se më 16 tetor 2008 kishte bërë aplikimin pranë të paditurës MTI, për regjistrim të markës tregtare “Fila Luxenmbourg”, ku ka kërkuar edhe të drejtën e përparësisë.

E drejta për regjistrim të markës tregtare, sipas këtij aktgjykimi iu ishte njohur paditësit mirëpo jo edhe e drejta e përparësisë për çka edhe ishte paraqitur konflikti administrativ.

Gjykata në fund të aktgjykimit thotë se kishte gjetur mospërputhje ndërmjet provave që gjendeshin në shkresa të kësaj lënde andaj lëndën e ka kthyer në rivendosje.

Për këtë rast palët nuk kanë paraqitur ankesë, ndërsa që nga koha kur “Fila Luxenmbourg” kishte paraqitur padi deri në ditën kur është marrë vendimi nga shkalla e parë kanë kaluar tri vite e pesë muaj.

12. Rasti i Bashkim Ukës Ndaj MPMS-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri kur aktgjykimi në këtë çështje administrative ka marrë formë të prerë, kanë kaluar 414 ditë)

Gjykatëse: Luljeta Maxhuni

Paditës: Bashkim Uka

E paditur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

Objekt shqyrtimi: Vendimi i datës 25 tetor 2017 i MPMS-së lidhur me refuzimin e të drejtës për ndihmë sociale

Data e paraqitjes së padisë: 27/12/2017

Data e vendosjes në Gjykatë Themelore: 14/02/2019

Aktgjykimi: Refuzues

Data e vendosjes në Gjykatë të Apelit: Nuk ka pasur ankesë

Bashkim Uka kishte paraqitur padi më 27 dhjetor 2017 ndaj MPMS, lidhur me refuzimin e kërkesës së tij për shfrytëzim të ndihmës sociale për shkak të kushteve të vështira ekonomike, kërkesë e cila iu ishte refuzuar më 25 tetor 2017 pasi që i njëjti sipas ministrisë nuk plotësonte kushtet e kërkuara.

Paditësi në këtë rast kishte kërkuar me padi këtë të drejtë pasi që i njëjti kishte probleme shëndetësore dhe kishte gjendje të keqe pasi që jetonte pa familje, mirëpo kjo kërkesë atij iu refuzua edhe nga Gjykata Themelore e cila më 14 shkurt 2019 vendosi që palës paditëse t’ia refuzoj padinë.

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, organi administrativ në këtë rast Ministria kishte vendosur drejtë kur i kishte refuzuar ndihmën sociale B.U, pasi që i njëjti nuk kishte plotësuar kriteret e parapara me ligj për përfitimin e një të drejte të tillë. Kjo pasi që B.U, thuhet në aktgjykim se nuk kishte deklaruar se jeton në bashkësi familjare dhe kishte paraqitur ndarje fiktive sepse kishte familje.

Ndaj këtij aktgjykimi paditësi nuk ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, ndërsa që nga koha kur i njëjti ka paraqitur padi deri në zgjidhjen e rastit kanë kaluar një vit e 2 muaj.

10. ANNEX 2: ANALIZË E DETAJUAR E RASTEVE KARAKTERISTIKE ADMINISTRATIVE TË CILAT GJENDEN NË PROCEDURË ANKIMORE

1. Rasti i Osman Karakay ndaj MPB-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri në aktgjykimin e shkallës së parë në këtë çështje administrative , kanë kaluar 161 ditë)

Gjykatëse: Anita Nikqi-Morina

Paditës: Osman Karakay

E paditur: Ministria e Punëve të Brendshme

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të MPB-së, të datës 20 mars 2018

Data e parashtrimit të padisë: 12/06/2018 **Data e vendosjes në Gjykatën Themelore:** 20/11/2018 **Aktgjykimi:** Aprovues (rivendosje)

Paditësi Osman Karakay kishte paraqitur padi në DÇA të GjTh të Prishtinës më 12 qershor 2018, ndërsa padia e tij është shqyrtuar nga gjykata pesë muaj më vonë, përkatësisht më 20 nëntor ku është aprovuar kërkesa e paditësit Karakay dhe rasti është kthyer në rivendosje te e paditura MPB³¹.

Këtë vendim e kishte marrë gjykatësja Anita Nikqi-Morina, më 20 nëntor të vitit 2018, pas mbajtjes së seancës për këtë rast.

Sipas këtij aktgjykimi, kërkesa e Karakay është e bazuar, ndërsa është anuluar vendimi i Komisionit të ankesave për të Huajt në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe urdhri për largim me forcë i datës 29 mars 2018, përderisa çështja do të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te MPB.

Ky vendim ishte shpallur në bazë të padisë së paraqitur nga Karakay, më 12 qershor 2018, i cili përmes saj kishte kërkuar anulimin e vendimit të MPB-së, përkatësisht komisionit të ankesave për të huajt për shkak se sipas paditësit nuk ishin aplikuar drejtë dispozitat ligjore, duke u konstatuar në mënyrë të gabuar gjendja faktike.

Sipas padisë, Drejtoria për Migrim dhe të huaj në kuadër të MPB-së më 29 mars 2018 kishte nxjerrë urdhër për largim me forcë përmes të cilit kishte vendosur që paditësin ta largoj nga Republika e Kosovës me arsyetimin se i njëjti përbën rrezik për sigurinë kombëtare të Kosovës.

Për këtë rast ka pasur ankesë në Gjykatën e Apelit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa rasti është kthyer sërish në rigjykim në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

³¹ "Gjykata anulon vendimin e MPB-së me të cilin njëri nga gjashtë "Gylenistët" ishte deportuar nga Kosova". Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2018. (<https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-anulon-vendimin-e-mpb-se-me-te-cilin-njeri-nga-gjashte-gylenistet-ishte-deportuar-nga-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 10 shtator 2019).

Kështu gjykata i ka dhënë prioritet këtij rasti që bëri bujë mediatike në mars të vitit 2018, duke vendosur për këtë rast në nëntor të vitit 2018.

Ndonëse raste të shumta të viteve 2016 dhe 2017 ende nuk kanë arritur të procedohen apo të kenë një vendim nga Gjykata, ky rast nuk priti shumë dhe përfundoi nga ana e shkallës së parë.

Vendime lidhur me kërkesën e njëjtë kanë marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë edhe pesë të depërtuarit e tjerë, gjatë vitit 2018.

2. Rasti i SBASHK-ut ndaj MASHT-it

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri në aktgjykimin e shkallës së parë në këtë çështje administrative , kanë kaluar 53 ditë)

Gjykatësja: Arjeta Sadiku

Paditës: SBASHK

E paditur: MASHT

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit të datës 26.02.2019 I Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Data e paraqitjes së padisë: 04/03/2019

Data e vendosjes në Gjykatën Themelore: 25/04/2019

Aktgjykimi: Refuzues

Gjykata Themelore në Prishtinë pas një muaji që SBASHK, kishte paraqitur padi, kishte marrë aktgjykim refuzues lidhur me kërkesën e të njëjtës për anulim të vendimit të së paditurës Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (MASHT).

Padia për këtë rast ishte ushtruar pasi që MASHT-i, më 27 shkurt 2019, kishte marr vendim për zëvendësimin e orëve të humbura për shkak të ndërprerjes së përkohshme të mësimin në institucionet e arsimit para universitar publik, si pasojë e grevës.

Në vendimin e MASHT-it thuhej se orët e humbura do të zëvendësohen pesë ditë gjatë pushimit pranveror, pesë ditë gjatë vitit shkollor dhe për pesë ditë do të zëvendësohen pas përfundimit të vitit shkollor.

Por, kundër këtij vendimi kishte qenë SBASHK-u, ku përmes padisë së ushtruar në gjykatë më 4 mars 2019, kishte kërkuar anulimin e këtij vendimi, me pretendimin se ai është i kundërligjshëm.

Përkundër pretendimeve të palës paditëse, gjykata ka lënë në fuqi vendimin e atakuar, me arsyetimin se i njëjti është i bazuar në Ligjin për Arsimin Para universitar, dhe se MASHT-i mban përgjegjësi kryesore për planifikimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit para universitar.

Në aktgjykimin e Gjykatës Themelore, thuhet se vendimi i MASHT-it është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se kompensimi i orëve të humbura me rastin e grevës ka për qëllim zhvillimin arsimor të nxënësve dhe aftësimin e tyre social dhe profesional, kjo në përputhje me parimet e përgjithshme të arsimit para universitar të përcaktuara me Ligjin për Arsimin Para universitar.

Ky aktgjykim është marr nga gjykatësja Arjeta Sadiku, ku thuhet se vendimi MASHT-it nuk është diskriminues, e as ndëshkues për paditësin, e as mësimdhënësit të cilët janë të obliguar me këtë vendim.

Gjykata për këtë rast ka marrë vendim brenda dy muajve pasi që është paraqitur padia ndërsa ndaj këtij vendimi ka pasur ankesë edhe në Gjykatën e Apelit, derisa rasti është ende në procedurë në shkallën e dytë.

3. Rasti i Auto Shtëpisë “KOMPRESORI” ndaj ATK-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri në aktgjykimin e shkallës së parë në këtë çështje administrative , kanë kaluar 1858 ditë)

Gjykatës: Rexhep Gashi

Paditës: Auto shtëpia “Kompresori”

E paditur: Administrata Tatimore e Kosovës”

Objekt Shqyrtimi: Anulimi i vendimit të ATK-së, raporti i kontrollit i vitit 2014

Data e paraqitjes së padisë: 10/03/2014

Data e vendosjes në Gjykatën Themelore:10/04/2019

Aktgjykimi: Refuzues

Auto-Shtëpia “Kompresori”, më 10 mars 2014 kishte paraqitur padi ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) , me pretendimin se e njëjta me rastin e realizimit të kontrollit në këtë kompani kishte aplikuar në mënyrë të gabuar ligjin që ka të bëj me fitimet dhe humbjet në kapital për biznes.

Sipas vendimit të 4 shkurtit 2014 të marrë nga Departamenti i Ankesave në kuadër të ATK-së, thuhet se refuzohet ankesa e subjektit “Kompresori”, pasi që është e pabazë dhe se vërtetohet raporti i kontrollit për njoftim rivlerësimit.

“Veprimtaria e subjektit është ofrimi i shërbimeve, kontrollime teknike dhe analiza, mirëmbajtje dhe kontrollim i automjeteve. Tatimpaguesi ushtron veprimtari edhe me një restorant prej vitit 2011. Subjekti është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në vitin 2005 me aksionar Marjan Marku dhe Gjergj Sylaj” thuhej në vendim të ATK-së.

Sipas këtij vendimi ATK, kishte zhvilluar një kontroll në këtë subjekt e pas ankesës së palës, rastin ishte kthyer në ri kontroll.

Kurse ATK, thotë se konstatimi në ri kontroll ishte i njëjtë me atë të mëparshëm për Marrëveshjen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit sipas të cilës shiten aksionet në vlerë prej 716,250.00 euro, ndërsa sipas kontratës së datës 16 qershor 2009 tatimpaguesi ka kryer shitje të një sipërfaqeje të pronës prej 110 ari me çmimin total prej 990,000.00 euro.

Lidhur me këto pretendime më 10 prill 2019 ishte shqyrtuar padia e “Kompresorit”, ndërsa gjykatësi I divizionit fiskal kishte marrë vendim që kërkesën e paditësit ta refuzonte sit ë pabazuar.

Në arsyetimin e vendimit thuhet se provat e prezantuara në seanca gjyqësore dhe raporti i kontrollit i ATK-së vërehet se ATK-ja në bazë të dispozitave ligjore kishte ngarkuar paditësin me detyrime tatimore për TVSH dhe Tatim në të ardhura të Korporatave.

“Paditësi nuk ka arritur të argumentoj me prova konkrete dhe bindëse një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendim kontestues dhe se dëshmitë e parashtruar nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative “thuhet në aktgjykim.

Pretendimi i paditësit në aktgjykim thuhet se nuk ishte vërtetuar sepse i njëjti nuk ka mund të vërtetoj faktin se ATK-ja kishte aplikuar gabimisht Ligjin për Tatimin në Të ardhura të Korporatave ngase pikërisht dispozita që është përdorur kishte të bënte me fitimet dhe humbjet në kapital për biznes.

Në fund kjo gjykatë potencon që vendimi i ATK-së ishte vendim i qartë dhe i kuptueshëm dhe në arsyetim përmbante mjaftueshëm elemente për fakte vendimtare të cilat kjo gjykatë i ka pranuar.

Ndaj vendimit të shkallës së parë, paditësi ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit, më 14 gusht 2019 ndërsa rasti ende është në procedurë.

Prej momentit të paraqitjes së padisë deri në zgjidhje të rastit nga shkalla e parë kanë kaluar 4 vite e 11 muaj.

4. Rasti i Noterit Isak Ademi ndaj MD-së

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri në aktgjykimin e shkallës së parë në këtë çështje administrative , kanë kaluar 9 ditë)

Gjykatëse: Anita Niqki-Morina

Paditës: Isak Ademi Noter

E paditur: Ministria e Drejtësisë

Objekt shqyrtimi: Kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të Ministrisë së Drejtësisë 03/06/2019

Data e paraqitjes së padisë: 03/06/2019

Data e vendosjes në Gjykatën Themelore: 12/06/2019

Aktvendimi: Aprovues

Noteri Isak Ademi kishte parashtruar në gjykatë kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të marrë nga ana e Ministrisë së Drejtësisë lidhur me lirimin e të njëjtit nga detyra e noterit për shkak të arritjes së moshës me të cilin vendim Ademit iu ishte ndaluar të ushtronte më tutje funksionin e noterit.

I pakënaqur me këtë vendim, Ademi kishte paraqitur padi e të njëjtës i kishte bashkangjitur kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit administrativ derisa të vendoset nga gjykata për padinë e tij.

Lidhur me këtë kërkesë të paraqitur më 3 qershor 2019 pikërisht në ditën kur të njëjti iu ishte dhënë vendimi i Ministrisë së Drejtësisë për mos ushtrim të funksionit të noterit, Ademi kishte paraqitur padinë në GjTh në Prishtinë ndërsa pas afërisht një jave gjykata ka vendosur në favor të tij duke aprovuar kërkesën e tij që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të Ministrisë së Drejtësisë.

Pas aprovimit të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, rasti është në proces në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Në vendimin e GjTh është paraparë edhe ankesa në afat prej 15 ditësh në Gjykatën e Apelit por Ministria e Drejtësisë nuk ka paraqitur ankesë.

5. Rasti i “BIOTEK” ndaj MPMS

(Nga data e parashtrimit të padisë, e deri në aktgjykimin e shkallës së parë në këtë çështje administrative , kanë kaluar 753 ditë)

Gjykatës: Hajriz Hoti

Paditës: “Biotek”

E paditur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale- Inspektorati I Punës

Objekt shqyrtimi: Anulimi i vendimit për shqiptim të gjobës 3000 mijë euro i Inspektoratit të Punës (MPMS)

Data e paraqitjes së padisë: 24/02/2017

Data e vendosjes në Gjykatën Themelore: 19/03/2019

Aktgjykimi: Refuzues

Personi juridik “Biotek” ka kundërshtuar vendimin e Inspektoratit të Punës me të cilin kjo kompani ishte gjobitur me 3000 mijë euro gjobë për shkak të shkeljes së ligjit të punës në dy aspekte, ku njëra prej tyre ishte mos shfrytëzimi i pushimit nga punëtorët me anë të padisë së paraqitur në vitin 2017.

“Biotek” kishte paraqitur padi më 24 shkurt 2017 në Gjykatë me pretendimin se gjoba e shqiptuar nga Inspektorati i Punës në kuadër të MPMS-së nuk kishte vërtetuar drejtë gjendjen faktike.

Sipas padisë, Inspektorati i Punës kishte aplikuar ndëshkime për këtë kompani për periudhën për të cilën nuk ishte kërkuar fare dokumentacion.

Mirëpo këtë pretendim të “Biotek” e ka quajtur si të pabazuar gjykata e cila ka refuzuar kërkesën e këtij subjekti për anulimin e vendimit të Inspektoratit të punës.

Rasti tani ka përfunduar edhe në shkallë të dytë sipas ankesës së këtij subjekti.

Nga dita kur ky subjekt ka paraqitur padi e deri në ditën kur e njëjta ka marrë vendim nga shkalla e parë kanë kaluar 2 vite.

11. REKOMANDIME

1. MD me rastin e draftimit të ligjit të ri për Konfliktet Administrative, të përcaktojë afate të qarta procedurale përmes të cilave zhvillohet procedura gjyqësore në konflikt administrativ.
2. MD të përcaktojë në mënyrë taksative rastet kur Gjykata ka të drejtë që lëndën ta kthejë në rivendosje, me qëllim të shmangies së praktikës së “ping-pongut” në mes Gjykatës dhe organit të administratës.
3. Sistemi gjyqësor të angazhohet maksimalisht që në drejtësinë administrative të sigurohet mjeti efektiv juridik, ashtu siç edhe përcaktohet me KEDNJ.
4. Aktgjykimet e Gjykatës në këto raste të jenë të arsyetuara, dhe në këto arsyeime, Gjyqtarët të aplikojnë jurisprudencën e GjEDNJ.
5. KGJK të angazhohet për rritjen e numrit të gjyqtarëve në këtë departament, veçanërisht në GjTh të Prishtinës. Po ashtu, përmes mekanizmave të brendshëm të kontrollit, KGJK të sigurohet që rritja e numrit të gjyqtarëve, të ndikojë në ngritjen e numrit të lëndëve të zgjidhura.
6. Gjykata e Apelit të shqyrtojë maksimalisht mundësinë që në rastet e saja të vendosë vetë, dhe jo qëllim në të shumtën e rasteve, lëndët ti kthejë në rigjykim.
7. Avokatura Shtetërore të sigurojë mbrojtje efektive të interesit publik. Ky institucion të paraqitet në seancat gjyqësore në këto raste. Po ashtu, edhe në shkresat dërguar gjykatës, këto shkresa të përpilohen si rezultat i trajtimit të detajuar të rasteve, dhe jo mbi bazën e “shabllojeve”.
8. Avokatura Shtetërore ngrisë nivelin e transparencës ndaj publikut, mediave dhe shoqërisë civile.
9. Për 200 lëndët “stand-by” në Gjykatën e Apelit, KGJK të marrë në përgjegjësi të gjithë akterët e përfshirë në këtë proces.
10. Përjashtimisht rasteve kur prioriteti i shqyrtimit të lëndës përcaktohet me ligj apo me vendime të KGJK-së, lëndët në Departamentin për Çështje Administrative të trajtohen sipas radhës së arritjes në Gjykatë.